

forum 2015

Analiza të shkurtëra të politikave publike: ÇKA SHKOI TERS?

PATOLOGJIA E NJË VONESE

10 gabime që frenuan perspektivën e energjetikës në Kosovë




Analiza të shkurtëra të politikave publike:
Çka shkoi ters?

Patologjia e një vonese?

10 gabime që frenuan perspektivën e energjetikës në Kosovë


Kjo analizë është punuar nga Luan Shllaku për Forum 2015.
Karikatura në ballinë: Jeton Mikullovc





Përmbajtja

1. Predimensionimi i investimit - Kosova e Re me 2,100 MW (Kafshata e madhe të mbet në fyt!)	6
2. Instruksione të gabuara të agjencive donatore ndërkombëtare (Dora e huaj nuk të kruan mirë!)	8
3. Mos respektimi i situatës reale në terren (Ku janë gjurmët atje është edhe ujku!)	11
4. Mos përgatitje adekuate e projekteve alternative (energja nga burimet e përtëritshme) (3 herë mat një herë prej!)	13
5. Mos respektimi i Politikave Energjetike të BE 2020 (Ndëgjo mirë nëse nuk sheh!)	17
6. Mos përgatitja e mirë e kërkesave për projekte investive (tenderit ndërkombëtar) (Çdo pësim është mësim!)	19
7. Vonesat e mëdha në ndërtimin e hidrocentralit Zhur (Më mirë vonë se kurrë!)	21
8. Injorimi i interesit ekonomik të vendit në investimin në TC Kosova e Re (Rruaju nga aksham pazari!)	22
9. Privatizimi i shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike (Pazari i mirë bëhet në mëngjez!)	25
10. Mungesë e një vizioni afatgjatë zhvillimor (Mos gjuaj në mjegull!)	28



Hyrje

Nuk ka fushë me diskurs më të polarizuar se që është ai për energjetikën në Kosovë. Vite me radhë qeveritarët na bindin se energjetika është fusha më premtuese dhe sfiduese për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë kosovare, dhe se në këtë kartë duhet mbështetur kur ta projektojmë perspektivën e ekonomisë së vendit. Në anën tjetër shumë ekspertë, OJQ, shoqata, intelektualë dhe një parti politike të paktën, mendojnë se vendimmarrësit janë larg realitetit kur e bëjnë projektimin e investimeve të reja në këtë sektor, sepse ju mungon vizioni dhe njohuritë e mjaftueshme për këtë fushë, si dhe janë të ndikuar nga qarqe ndërkombëtare të interesit, nga brenda dhe jashtë, për të çuar ujë në mullirin e tyre, e jo tonin! Rezultat i drejtpërdrejt i këtij diskursi shumëvjeçar janë vonesat e mëdha në avancim të këtij sektori që pritet të jetë në thelb të zhvillim it të ardhshëm ekonomik të vendit.

Në periudha të ndryshme të pas luftës zhvillimet në energjetikë kanë mobilizuar shumë para dhe institucione ndërkombëtare të cilat së bashku me KEK-un kanë tentuar të gjejnë zgjidhje adekuate. Nëse shohim natyrën e intervenimeve dhe planeve të bëra për ta rimëkëmbur këtë sektor, mund të dallojmë tri periudha karakteristike: (1) paslufta, rimëkëmbja e sistemit ekzistues gjatë 2000-2002, kur u investuan rreth 500 milion euro kryesisht në termocentralet ekzistuese Kosova A dhe B, (2) konsolidimi i prodhimit (përfshirë fillimin e zhvillimit

me investime buxhetore në mihjen e re) pas investimeve të alokuara në 2003-2008, që kushtuan mbi 650 milion Euro, dhe (3) kërkimi i zgjidhjeve afatgjata për energjetikën kosovare, duke hartuar plane dhe strategji për investimet e ardhshme, nga viti 2005 deri sot.

Të tri këto periudha gëlltitën tepër shumë para të tak-sapaguesve ndërkombëtar dhe Kosovar - më shumë se 1.2 miliard Euro deri tash¹. Situata aktuale nuk është shumë më e avancuar se ajo që e kishim në vitin 2000, me disa përjashtime. Në rend të parë ky konstatim vlen për strukturën e kapaciteteve gjeneruese, që ka mbetur e njëjtë, ku shpenzimet kryesore kanë shkuar për intervenime kryesisht në mirëmbajtje investive dhe të rregullt në TC Kosova B dhe mihje sipërfaqësore, dhe në disa blloqe të TC Kosova A. Edhe pse nga viti 2005, me jo pak pompozitet, shpallen projektet investive në një termocentral të ri me linjit, më vonë edhe ne hidro-centralin Zhur, asgjë konkrete deri tash nuk është bërë. Këto projektet do të duhej të ishin investimet më kapitale në ngritjen e performancës të sektorit energjetik, i cili do të duhej të ishte në gjendje jo vetëm të mbulonte kërkesat për energji elektrike vendore, por edhe për të eksportuar energji në rajon, kjo në periudha të veçanta kur kemi teprica, pas mbulimit të kërkesës së brendshme.

1 Në Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës për Periudhën 2009-2018 shënohet se prej fundit të vitit 1999 deri në vitin 2008, KEK-u ka pranuar rreth €1,052 milionë në formë subvencionesh, prej të cilave €459 milionë nga Buxheti i Kosovës dhe €593 milionë nga donatorët.

Në këtë analizë janë paraqitur problemet kryesore që ka hasur zhvillimi i sektorit energjetik si dhe qasjet e gabuara, të aplikuara për zgjidhjen e tyre. Kjo analizë përmbledh një vështrim kritik të gabimeve të bëra nga një spektër i gjerë institucioneve të angazhuara në drejtimin e sektorit, si atë prodhues aktual ashtu edhe përgatitjen për investimet e ardhshme. Në vazhdim, është dhënë një kalendar i gabimeve të bëra nga ana e institucioneve vendimmarrëse dhe atyre me mandat vendim-marrës strategjik për këtë sektor. Ky kalendar ka për qëllim të tregojë edhe se vendimet e marra, sado të gabuara që shihen, nuk e kanë vetëm një adresë, ato janë në të shumtën e rasteve pjesë e një veprimi të orkestruar të institucioneve vendimmarrëse qofshin në Qeveri, Parlament, agjencione të pavarura, ose edhe në mesin e institucioneve ndërkombëtare, që punojnë në këtë fushë.


1. Predimensionimi i investimit - Kosova e Re me 2,100 MW



Një pjesë e madhe e energjisë së ekspertëve qëllim-mirë dhe e shoqërisë civile është shpenzuar gjatë viteve 2005-2010 në sjelljen e dëshmimeve se termocentrali i planifikuar Kosova C është i stërdimensionuar, dhe si i tillë do të shkaktonte shumë më shumë dëme se dobi. Në studimin “Një Përrallë Moderne” të bërë poashtu nga Forum 2015², në mars të vitit 2007 janë sjellë 14 dëshmi se ky projekt i Qeverisë së atëhershme të Kosovës do të sillte dëme ambientale dhe shëndetësore, do të sillte konflikte të pa-riparueshme në mes të disa sektorëve ekonomik si atyre të bujqësisë dhe ekonomisë ujore, dhe do të shkaktonte lëvizje të pa-favorshme demografike. Mbi të gjitha, ai nuk do të sillte përfitime ekonomike adekuatë, dhe është paraparë të ndërtohet në një lokacion shumë të papërshtatshëm me ndikim negativ enorm mbi pothuaj gjysmë milion banorë që jetojnë pothuajse nën tymtar!

Si u përcaktua kapaciteti prej 2,100 MW për termocentralin Kosova C? Në rend të parë idea e ndërtimit të një termocentrali (TC) kaq të madh daton në fund vitet e 80-ta, kur Elektroekonomia e atëhershme (KEK-u i sotit), e ngriti një zyrë të posaçme që do të merrej me

2 “Një Përrallë Moderne”, Forumi 2015, mars 2007



përgatitjen e terrenit për ta ndërtuar një termocentral në Kosovë, fare afër TC Kosova B, me kapacitet 2,100 Më, në të cilin do të investonin disa Elektroekonomi Jugosllave të asaj kohe. Sipas idesë fillestare të fundit të viteve 80-ta, ai termocentral i madh parashihej ti kontribuonte plotësisht të nevojave të Serbisë dhe republikave tjera Jugosllave. Kjo ide është restauruar pas vendosjes së Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM) pasi që kishin vendosur të ndërtonin diçka të madhe! Ky fakt jo patjetër do të duhej të ishte dominant në përcaktimin e fuqisë së TC-së që do të ndërtohej, por sigurisht se ka qenë me influencë. Ajo që idenë e 2,100 MW e institucionalizoi dhe e solli fare afër nënshkrimit të kontratës për investim/ndërtim, ishte përkrahja e pa rezervë që këtij procesi i hanë Banka Botërore, USAID dhe BE, të cilat duhet thënë, investuan shumë në përpunimin e kësaj ideje, qoftë me studime në terren³ qoftë me kampanja “ndërgjegjësuere dhe edukative” me popullatën e Komunës në Kastriot, ku do të paraqiteshin konfliktet më të mëdha me këtë mega TC.

Në këto vite është bërë poashtu edhe studimi i nevojave për kapaciteteve të reja gjeneruese në rajon⁴,

3 Projekti ESTAP I, II, III, i financuar nga BB, Studimi i vitit 2005 mbi prefizibilitetin e termocentralit Kosova C me 2,000-2,100Më - financuar nga KE-ja (nëpërmjet AER-it), “Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social” i financuar nga BB në kuadër të asistencës teknike për projektin PATEL, e tjera studime të nevojshme për mbështetjen e zhvillimit të termocentralit Kosova C.

4 Final Report: “Regional Balkans Infrastructure Study – Electricity (REBIS) and Generation Investment Study (GIS)”,

kryesisht nga kompani ndërkombëtare me renome, me pjesëmarrje edhe të atyre rajonale (që tashmë kishin njohuri dhe gisht në idenë e viteve 80-ta për ndërtimin e 2100 MW), për të shqyrtuar dhe argumentuar ndërtimin e një termocentrali kaq të madh në Kosovë. Këto studime përdorëshin kurdo që duhej të argumentohej nevoja për një fuqi të madhe gjeneruese, që do ta “shpëtonte” tërë Ballkanin të cilit (sipas skenarit B – atij rajonal) i duhen 11,000 GW kapacitete të reja gjeneruese deri në vitin 2020⁵, përveç 11.5 GW kapacitete ekzistuese që kërkohet të rehabilitohen. Studimet e BB, USAID, BE dhe ato rajonale do të duheshin t’i fusin në hije të gjithë zërat që e kundërshtonin këtë ide. Disa nga këto studime sillnin gjëra jo vetëm anakronike, por edhe jo të sakta. I tërë argumentimi që bënin duhej t’i shkante përshtati idesë të ndërtimit të 2,100 MW, të cilat, dëshmohej, nuk mund të kenë ndikim shumë negativ dhe të përballueshëm, sepse TC të tilla ndërtohen gjithandej! Në ndërkohë, mungonte “Vlerësimi i Ndikimit Strategjik Mjedisor dhe Social” – i cili, u realizua më vonë me financim të BB në kuadër të Projektit PATEL, edhe pse mungonte studimi i çmimit ekstern të këtij investimi, i - “Eksternalitet Mjedisor”, dhe mungonte “Master Plani i Ujërave”, që zakonisht e përcjell çdo projekt të madh si ky - përpos nëse bëhet në Kosovë! Sot, 7-8 vjet pas, këto studime kanë filluar të vlerësohen, rishikohen dhe finalizohen nga disa institucione ndërkombëtare. Paradoksi

31 dhjetor 2004, që parasheh se në Kosovë, gjatë periudhës 2005-2020, duhet të ndërtohen 4,000-4,200 MW kapacitete të reja gjeneruese.

5 Po aty ...

i kësaj situate është jo vetëm se janë humbur 7-8 vjet deri tash, por edhe se këto studime që duhet të jenë përcaktuese për vendimet që marrim: sa, si, dhe ku do të ndërtojmë, bëhen “post mortem”, pasi që deri para 2-3 viteve ishim përcaktuar paraprakisht se Sa (2,100MW), Si (duke djegur linjit) dhe Ku (në Kastriot, përkrah termocentraleve ekzistuese) do të ndërtonim! Pra, janë neglizhuar të gjeturat e studimeve të cilat as që mund të quhen të besueshme pasi janë bërë vetëm pro-forma!

2. Instruksione të gabuara të agjencie donatore ndërkombëtare




Institucionet ndërkombëtare e kishin dhe akoma e kanë një rol dominant në përcaktimin e ardhmërisë sonë energjetike. Bashkimi European (BE) Banka Botërore (BB), dhe USAID në faza të ndryshme të mëkëmbjes energjetike të vendit e mbajtën gjallë tërë sistemin, e konsoliduan prodhimin dhe e stabilizuan atë. Për këtë

ato shpenzuan shumë para të taksapaguesve European, Amerikan dhe më gjerë. Qëllimi i këtij raporti është të analizojë vetëm gabimet e bëra, dhe s’do të duhej të shihet si nihilizim i rolit shumë pozitiv që këta donatorë e patën dhe akoma e kanë në energjetikën kosovare. Por, kush punon gabon, dhe këto gabime nganjëherë mund

të kushtojnë shumë. Ato sigurisht kushtojnë shumë kur nuk ka ndonjë institucion kritik që bëhet partner para se të bëhet “kallfë” i këtyre institucioneve. Fjala është për qeveritë e Kosovës që asnjëherë nuk arritën të bëhen partner të denjë dhe të barabartë me këto institucione dhe ekspertët e tyre, që jo gjithmonë qonin ujë në mullirin tonë (në interes të Kosovës). Dhe, këtu është fjala për një kategori ekspertësh që donatorët ndërkombëtar i angazhojnë për të na ndihmuar në përgatitjet për zhvillim të projekteve energjetike të vendit. Dhe, nëse ka mosnjohje të interesit tonë kombëtar, mosnjohje të situatës reale në terren dhe abuzime nga qëllimi ose injoranca me “këshilldhënien”, atëherë këtë e bënin këta ekspertë - disa këshilltar të transaksionit, që punojnë për kompani botërore këshillëdhënëse, dhe që janë jo plotësisht të imunizuar nga ndonjë tentativë për ndikim nga kompanitë komerciale botërore të interesuar për të investuar në Kosovë. Përndryshe, si mund të kuptohet këshilldhënia e tyre e cila gjatë periudhës 2005-2009 sillte argumente të flakta pro ndërtimit, të një TC me kapacitet 2100 MW, dhe më vonë, pas 2-3 vitesh, ishin për ndërtimin e kapaciteteve të vogla: 500MW - 600MW. Cila është këtu fjala e ekspertizës së huaj? Janë 2,000 MW apo janë vetëm deri në 600 MW që mund t’i ha pazari jonë energjetik! Ishin të flaktë kur na bindnin për 2,100 MW siç janë të flaktë edhe sot kur na bindin se asgjë mbi 600 MW nuk duhet filluar të ndërtohet. Fillimisht, një mega TC⁶, i mbetur gjatë

⁶ Kompania elektrike RWE instaloi në vitin 2011 dy blloqe gjeneruese nga linjiti me nga 1,100MW secili. Ky termocentral ndodhet në lokacionin e linjtit të Lower Rhine afër Grevenbroich, Germany, dhe është termocentrali më i madh në botë që djeg linjit. (<http://www.power-technology.com/projects/rwe-neurath/>)



si opcion i vetëm zhvillimor i dy qeverive (edhe i kësaj sot⁷) e përkrahën ata që duhej dhe ata që s'duhej! Ata që duhej, ose të paktën që qëndrimi i tyre mund të justifikohet, do të ishin zyret dhe ambasadat e vendeve që kishin interes direkt në këtë investim, sepse kompani të vendeve të tyre kishin shprehur interesim për ndërtim. Ata që s'duhej përkrahur këtë skenar investimi, janë donatorët multilateral si BB dhe BE, dhe mbi të gjithë, qeveritë tona që me një propagandë të sheqerosur mirë, dëshmonin se pas këtij investimi Kosova e merr hovin ekonomik - dhe bëhemi fuqi rajonale! Hiqe BB e cila ishte në shënjestër të shumë institucioneve të shoqërisë civile botërore⁸ për politikën e saja jo-relevante në mbështetje të shteteve që të investojnë në energji me origjinë fosile, e posaçërisht në thëngjill⁹, përkrahja më e çuditshme që projekti Kosova C me kapacitet 2100 MW e mori ishte ajo e BE-së, nëpërmes të zyrës së saj në Kosovë. Kjo përkrahje qëndroi e tillë deri në vitin 2009, kur BE modifikoi qëndrimin rreth këtij projekti

7 PDK sa ishte në opozitë kundërshtoi fuqishëm TC Kosova C me 2,100MW, dhe propozonte afër 500MW

8 World Bank Attacked For Encouraging Climate Change, <http://the-energycollective.com/david-k-thorpe/60470/world-bank-attacked-encouraging-climate-change>

9 Sipas prestigjiozes britanike The Guardian të datës 8 prill 2010, Banka Botërore, duke mos konsideruar protestat ndërkombëtare (prej një koalicioni të aktivisteve vendorë, atyre fetarë, dhe atyre mjedisorë që thanë se do të dëmtohej mjedisi dhe pak do të ndikohet në emeliminimin e varfërisë) dhe kritikën e mprehtë nga Administrata Obama që projekti do të ndikojë në ndryshimet klimatike, miratoi një kredi kontraversiale prej \$3.75 miliard për ndërtimin e një termocentrali me qymyr në Afrikën e Jugut. USA. Britania, Holanda, Italia dhe Norvegjia abstenuan në votim në formë proteste ndaj kësaj kredie.

duke kërkuar më me forcë që të respektohen *acquis* për energji, mjedis dhe konkurrencë¹⁰. Kjo shënoi një ndërrim të plotë të kursit që Qeveria e Kosovës nuk pati qare pa e mbështet: në mënyrë spektakulare, por për të mirë, BB dhe BE publikisht shpallën se do të mbështesin vetëm një TC me 500-600 MW fuqi.

Reduktimi i kapacitetit gjenerues të termocentralit të ri në 500-600MW nuk i shtoi aspak shanset reale për afrimin e fillimit të ndërtimit të këtij termocentrali, përkundrazi, me futjen e TC Kosova B në pakon tenderuese të këtij projekti, këto shanse u zvogëluan edhe më shumë. Pakoja tenderuese u bë aq e komplikuar saqë, edhe pse Qeveria ofroi gjithçka për investorët e përzgjedhur – bile edhe në dëm të interesave të Kosovës, çdo specialist objektiv me mendje të ftohtë gjykonte se realizimi i këtij projekti ishte i pamundur edhe për shkak të kushteve aktuale të krizës në financat botërore. Këtë nuk arritën ta kuptojnë edhe këshilltarët e BB dhe USAID.

Fillimisht BB ka qenë për lidhjen e çmimit të energjisë elektrike me çmimet perspektive të tregut rajonal të energjisë (praktikisht kjo nënkupton edhe valorizimin e vlerës së linjitit duke e lidhur atë indirekt me kushtet e tregut). Por, ky koncept u braktis për tu zëvendësuar me parimin e Qeverisë që është: e fiton projektin ai që

10 Komisioni Evropian disa herë në raportet e tij të Progresit për Kosovën ka shënuar se Kosova duhet të sigurojë se do të zbatohen *acquis* të BE për energji, mjedis dhe konkurrencë, siç obligohet nga Traktati për Komunitetin e Energjisë.

ofron çmimin më të ulët të energjisë elektrike¹¹. Këtë çmim, nëse parashihet se do zbatohen kushtet e tregut, nuk mund ta ofrojë asnjë investitor serioz privat meqë në të ardhmen çmimet e energjisë do t'i vendosë tregu i lirë ku Kosova domosdo do të jetë pjesë pasi ka vendosur ti bashkohet BE-së dhe në ndërkohë ka nënshkruar Traktatin për Komunitetin e Energjisë. Ndërkohë, është për t'u theksuar se, sidomos në periudhën e parë 2005-2008, baza ligjore dhe rregullatore për sektorin energjetik dhe minerar ishte mjaft e pazhvilluar. Ky fakt e bënte mjaft jorealiste dëshirën për të ndërtuar me investime private të huaja një TC aq të madh në kornizë të një pakete komplekse ku futej edhe Mihja e Re e Sibovcit edhe Rehabilitimi i TC Kosova A. Edhe plotësimet dhe avancimet që i janë bërë bazës ligjore dhe rregullatore të sektorit prej vitit 2010 me miratimin nga Kuvendi të tri ligjeve bazike për sektorin energjetik, dhe ligjit për sektorin minerar, si dhe Ligjit për Partneritet Publiko Privat, mund të thuhet pa ngurrim se akoma ka nevojë për përmirësime dhe plotësime të mëtejshme të kornizës ligjore dhe rregullatore, ashtu që vërtet të mund të presim investime të huaja multi-miliardëshe.

Ja cilat ishin gabimet/deklaratat konkrete që këto agjenci i bënë gjatë “këshilldhënies” për ndërtimin e termocentralit Kosova C:

11 Shtojca 9 e Dokumentit Vlerësues të Projektit për PATEL të BB, i vitit 2006, parasheh se Qeveria e Kosovës do të përfitojë të ardhura në formën e qirasë ekonomike mbi të drejtën për shfrytëzimin e linjitet për prodhimin e energjisë për eksport. Atëkohë, për analizat e saj ekonomike, BB e pranonte këtë qira në nivelin e 5 Euro/ton linjit të shfrytëzuar.

- “Argumentuan” apo mbështetën, pa argumente bindëse, se ndërtimi i TC me deri 2,100MW në total është plotësisht në harmoni me investimet që sot bëhen kudo në botë¹²,


- Deklaronin se studimet që ata patën financuar deri atëherë e justifikojnë një investim të tillë, në ndërkohë që nuk e kishin bërë asnjë studim të plotë të ndikimit në mjedis (SESA)¹³,

- Vazhdimisht mendonin se Kosova duhet të ndërtojë kapacitete të mëdha, sepse vetëm në këtë mënyrë do të jetë në gjendje ta zhvillojë ekonominë e saj të dobët, energjia do të përbënte “motorrin e zhvillimit” të Kosovës¹⁴,

12 Fakti është se në vitet 2006-2007 pati shprehje paraprake të interesit nga investitorë të huaj për të ndërtuar në dy faza në total 1,800MW - 2,100MW kapacitete të reja gjeneruese, siç ofrohej nga Qeveria e Kosovës në Kërkesën për Shprehje të Interesit për Projektin Kosova C. Por, më pas, me fillimin e krizës financiare botërore, ky interes u dobësua ndjeshëm. Për ta mbajtur këtë interes të investitorëve të huaj, këshilltaret e BB dhe USAID bënë gabimin që në fund të vitit 2009 e këshilluan (në fakt diktuan) Qeverinë që të fuste në pakon e projektit Kosova e Re (ish Kosova C) edhe Rehabilitimin e TC Kosova B, me argumentin se kështu ishte me mirë ekonomikisht për Kosovën dhe për investitorët privat të interesuar. Ashtu siç edhe kishte pretenduar një pjesë e madhe e shoqërisë civile, kjo qasje rezultoi të ishte plotësisht gabim dhe tenderi për këtë projekt dështoi ngaqë investitorët, mes të tjerave, tani kërkojnë largimin e TC Kosova B nga pako tenderuese e projektit Kosova e Re.

13 “Një Përrallë Moderne” - Forum 2015, Prishtinë 2007

14 Ishte Komisioni Evropian ai që gjatë viteve 2004-2005 financoi dhe BB menaxhoi studimin rajonal GIS (Generation Investment Study), ku parashihej që në Kosovë ishte me leverdi të ndërtoheshin 4,000 deri në 4,200MW kapacitete të reja gjeneruese nga linjiti gjatë periudhës 2005-2020, energji që do të mbulonte kërkesat



- Veçanërisht ishin të pajustificuara konstatimet se TC-të moderne nuk janë ndotëse dhe se situata e përgjithshme ambientale do të përmirësohet pas ndërtimit të kësaj TC!
- Mbështetën politikën e MEM dhe KEK për rehabilitimin e TC Kosova A, që akoma sot është në kundërshtim me të gjitha normat mjedisore dhe duhet të dekomisionohet deri në vitin 2017¹⁵, dhe
- Nuk u shprehen asnjëherë me një zë dhe publikisht mbi përputhshmërinë e plotë ose jo të mënyrës se si ishte dizajnuar e paketuar Projekti Kosova e Re me *acquis* të BE për energji, mjedis dhe konkurrencë, sidomos sa i përket çështjeve të monopolit dhe kontratave afatgjata për shit-blerje të energjisë me çmime të fiksuara dhe jo sipas çmimeve të tregut. Këtë duhej ta kishte bërë me kohë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, dhe ai duhet ta bëj këtë.

vendore dhe kryesisht do të eksportohej në tregun rajonal duke shërbyer si “motor zhvillimor” për Kosovën. Ishin këto institucione që mbështetën në mënyra të ndryshme përgatitjen e Strategjisë së Energjisë 2006-2015 ku parashihej që kapaciteti i ri gjenerues prej 1,000MW të ndërtohej deri në vitin 2012, në kuadër të termocentralit Kosova C. Ishte BB e mbështetur fuqishëm nga USAID që, në kuadër të projektit të asistencës teknike PATEL, vazhduan ta mbështesin deri në vitin 2009 idenë e termocentralit të madh i cili në fazën e parë do të kishte rreth 1,000MW. Pra, ishin këto institucione që zhvilluan ‘apetit’ e Qeverisë për të synuar gabimisht ndërtimin e kapaciteteve enorme gjeneruese që aktualisht kanë rezultuar të pamundshme për shumë arsye.

15 Rehabilitimi i TC Kosova A parashihet në Strategjinë e Energjisë 2006-2015 që u përgatit me mbështetjen e AER (ish Zyra e KE në Kosovë). Në vitin 2005, AER financoi edhe studimin për leverdinë e rivitalizimit të TC Kosova A.

Të gjitha këto gabime, të thëna rrallë në opinion, por të përcjella te ministri i energjetikës ose Kryeministri nëpërmes të këshilltarëve të transakcionit, amplifikoheshin tutje nga radhët e qeveritarëve, të cilët një ditë filluan t’i besojnë edhe vetë këto “argumente”, dhe u bënë promovues të flaktë të këtyre mësimave!¹⁶

3. Mos respektimi i situatës reale në terren



Nuk mund të thuhet se ekspertët ndërkombëtarë dhe sidomos ata lokal nuk e njohin situatën në terren - zonën ku janë vendosur termocentralet ekzistuese dhe mihjet e linjitet. Por, kjo zonë, e njohur mirë që disa dekada, është studiuar pjesërisht: janë analizuar operatorët veçmas, dhe nuk është bërë

asnjë studim i shënuar që këta operator i sjellë në ndërlidhje jo vetëm me njëri tjetrin, por edhe me një mjedis social dhe ekonomik, urban dhe ndër-urban, me të cilin rrethohen, në një diametër 30-50 km, ku shtrihet ndikimi i tyre.

16 Këtu duhet ndarë rolin pozitiv që e pat luajtur në shumë raste ministrja e energjisë Prof. Dr. Justina Pula, e cila në mjaft raste u përpoq edhe publikisht që në dizajnin e këtij projekti të zbatohen të gjitha *acquis* të BE-së për energji, mjedis dhe konkurrencë, si dhe të vendosen sa më mirë në plan të parë interesat e Kosovës duke synuar arritjen e një partneriteti ‘win-win’ mes Kosovës dhe investitorit privat që do të fitonte të drejtën për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re (ose njësoj atij Kosova C).

Konfliktet e shumta që i sjell një investim i madh si ndërtimi i TC Kosova e Re, i cili ka për bazë djegien e linjitet që gjeneron shumë ndotës në ajër, ujë dhe tokë, janë jo vetëm mjedisore. Ato shtrihen shumë më thellë: (1) situata me bilancet për ujëra përkeqësohet më shumë, sepse termocentralet janë gëlltitëse të mëdha të tij¹⁷; (2) sektorët konkurrues Energji - Bujqësi, Energji - Ekonomi, futen në konflikte ku të gjitha palët humbin¹⁸; (3) stimulohen lëvizje demografike të pafavorshme të popullatës që jeton në zonën e ndikimit të TC-ve¹⁹; dhe 4) shëndeti i popullatës që jeton në një zonë të gjerë rreth TC-ve, me afër 700.000 banorë, është në mënyrë permanente i sulmuar nga ndotësit që sjellin shumë dëme shëndetësore²⁰. Të gjitha këto shumë pak ose fare nuk janë marrë parasysh nga ata që përgatitin tenderin për ndërtimin e termocentralit të ri. Edhe pas përfundimit të studimit të Ndikimit Strategjik Social dhe Mjedisor²¹, pjesa më e madhe e këtyre konflikteve mbetet e pa trajtuar fare ose të paktën si duhet. Ky studim i përfunduar vetëm pas presionit të ushtruar nga Forumi 2015, duket se ishte sa për sy e faqe. Konstatimet ishin jo plotësisht të besueshme, shpesh të pasakta dhe çonin ujë në mulli të vendim-marrësve të atëhershëm që donin të ndërtonin gjithsesi, pa marrë parasysh çmimin e kësaj ndërmarrjeje.

17 , Kosovo Water Strategy (BE) dhe BB. "Një Përrallë Moderne" - Forum 2015, Prishtinë 2007

18 Po aty

19 ESTAP III, Prostorni plan zone uticaja KXEMK, L. Shllaku: Konfliktet mjedisore në zonën e ndikimit të TC-ve

20 Dispanzeri i punës së KEK, Dr Xhevat Pllana: "Një përrallë moderne", raport sintetik për studimin.

21 Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS ose SESA), 2007-2008


Fare shkurt: (i) emisioni i pluhurit tejkalon aktualisht 10 deri në 40 herë koncentrimet e lejuara me direktiva të BE-së që duhet respektuar²², (ii) dyoksidi i sulfurit dhe oksidet e azotit po ashtu emitohen në sasi shumëfish më të lartë²³ se standardet e cekura; (iii) ujërat efluent janë të ndotur dhe e përkeqësojnë dukshëm cilësinë e lumit Sitnicë dhe Ibër, sidomos me fenole të rrezikshme; si dhe (iv) tokat në një diametër të madh përreth TC-ve janë të ndotura shumëfish, kryesisht me pluhur të TC-ve që ka një përbërje shumë toksike. Një ndër efektet e drejtpërdrejta ambientale, por edhe ekonomike është zënia e tokave të cilat tashmë e kanë zvogëluar fondin edhe ashtu të varfër të tokave bujqësore në Kosovë, për së paku 12.000 hektarë²⁴.

Situata e përgjithshme me ujëra në Kosovë është e rëndë. Sidomos në Kosovën lindore, ku në një segment të gjatë, nga Ferizaj deri në Mitrovicë, rrjedh vetëm lumi Sitnicë që është shumë i vogël për t'i pranuar gjithë ujërat industrial që vijnë nga operatorët e KEK-ut (TC-të, mihjet, tertorja etj.), Ferronikeli, e deri te Trepça në veri. Ky lum i vogël, poashtu është i ngarkuar me ujërat urbane që derdhen nga Prishtina, Podujeva, Glogovci e shumë qendra tjera nëpërmes të lumenjve Drenica, Prishtevka, Vellusha dhe Llapi. Ky lum është shndërruar

22 Ky obligim del jo vetëm nga fakti se jemi rrugës për të aderuar në BE por edhe nga obligimi i përmbushjes së TKE të nënshkruar më parë.

23 Sipas Raportit Mjedisor të KEK sh.a. për vitin 2011, emetimet ndotëse nga termocentralet ekzistuese (mg/Nm³) janë: Pluhuri: 917 (TCA) dhe 465 (TCB) - limiti i BE është 50; dyoksidi i sulfurit: 616 (TCA) dhe 620 (TCB), limiti i BE 400; Oksidet e azotit: 689 (TCA) dhe 791 (TCB), limiti i BE është 500.

24 Shllaku, L., Landner, L. Environment in Kosovo, Stockholm 1994



në një kanal të hapur të ujërave të ndotur. Në anën tjetër, tashmë është dëshmuar nga disa studime²⁵, se sasia e ujit që mund të jetë në dispozicion për termocentralet e reja me thëngjill, ose edhe industrinë e rëndë, sidomos pas aktivizimit të Trepçës, është shumë e mangët²⁶.

Afër 700.000 banorë jetojnë në zonën e ndikimit të TC-ve ekzistuese²⁷. Dendësia e banimit shkon edhe deri në 700 banorë/km², që e bën situatën me ekspozimin e banorëve ndaj ndotjes enorme edhe më të vështirë. Janë dy procese demografike që dalin nga kjo situatë: (1) evakuimi i organizuar i fshatrave²⁸ që janë pothuajse

nën tymtarë ose fare afër mihjeve, dhe (2) ikja graduale natyrore e popullatës nga kjo zonë. Por, me gjithë këto procese që do të zvogëlonin numrin e qytetarëve

25 Siguria e ujit për Kosovën qendrore, BB Mars 2012, http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Executive_Summary_Water_Security_for_Central_Kosovo_Alb.pdf, Një Përrallë Moderne", 2007, raporti sintetik i Bashkim Kabashi për kwtw studim,

26 Studimi i vitit 2008, financuar nga AER, "Furnizimi me Ujë nga Hidrosistemi Ibër-Lepenc për Termocentralin e Propozuar Kosova C" nuk kosideron riaktivizimin e Trepçës dhe nevojat e saj për ujë. Sipas këtij Studimi, kërkohen edhe të paktën 12 milion Euro investime kapitale ashtu që të mund të sigurohet furnizim me ujë për termocentralet, përfshirë këtu edhe termocentralin e ri. Ky studim identifikon edhe disa rreziqe: që shkaktohen nga baseni akumulues (apo nga zgjidhjet tjera të më larta) si: (i) Shkatërrimi i kanalit kryesor për shkaqe natyrale (rrëshqitje e dheut); (ii) Sabotimi i kanalit kryesor; (iii) Ndërprerja e ujit që vjen nga liqeni Ujman për shkaqe politike; dhe (iv) Rritja dramatike e humbjeve të ujit nga kanali kryesor nëse nuk kryhen riparimet urgjente.

27 L. Shllaku, Ndotja e mjedisit në zonën e impaktit të termocentraleve të Kastriotit, shtator 2009, Prishtinë.

28 ESTAP III, Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS ose SESA), 2007-2008, dhe Planet e Veprimit për Zhvendosje

të ekspozuar ndaj ndotjes, problemi më i madh mbetet afërsia e madhe me kryeqytetin, Prishtinën, e cila është vetëm 3.5 kilometra në vijë ajrore larg tymtarëve; Me vite, kjo afërsi do të rritet, dhe një ditë mund ti kemi deponitë e hirit brenda qytetit. Plani i ndërtimit edhe të TC të reja në këtë zonë do të ketë ndikim afatgjatë dhe më intensiv në shëndetin e popullatës.

4. Mos përgatitje adekuate e projekteve alternative (energja nga burimet e përtëritshme)



Investimi në burime alternative të energjisë (që njihen si burime të përtëritshme) ka qenë plotësisht jashtë planeve dhe veprimit konkret të qeverive deri sot. Linjiti ishte i vetmi burim me të cilin janë marrë në mënyrë serioze qeveritarët dhe konsulentët e tyre ndërkombëtar. Duhet përmendur se ka kohë që planifikohet edhe një hidrocentral në Zhur, por ai tërë kohën mbetet në prapavijë të veprimit, dhe nuk duket se është duke u menduar dhe punuar seriozisht për ndërtimin e tij. Kohëve të fundit, fal veprimeve të shoqërisë civile²⁹ është krijuar një diskurs publik, që duhet të intensifikohet më tutje. Meqenëse, argumentet shëndetësore, mje-

29 Është krijuar një rrjet i OJQ-ve "IDERK" që angazhohet për përdorimin e burimeve të përtëritshme

disore por edhe ekonomike vështirë që mund të sjellin ndryshime në planet qeveritare, atëherë duhet të bëhet presion me obligimet që qeveria ka për t'i përmbushur kriteret ndërkombëtare, ato të BE-së në radhë të parë, për zvogëlimin e emetimit të gazrave të dëmshme nga djegia e karburanteve fosil për 20%, rritjen e përdorimit të energjisë së pastër (nga burimet e përtëritshme) për 20%, si dhe ngritjen e efijencës së përdorimit të energjisë për 20%³⁰.

Në 10 nëntor 2010, Komisioni Evropian paraqiti strategjinë e tij të re për periudhën 10-vjeçare deri në vitin 2020 titulluar "Energjia 2020 – një strategji për energji konkurruese, të qëndrueshme dhe të sigurtë". Kjo strategji kërkon ndërmarrjen e veprimeve në fushën e efijencës së energjisë, infrastrukturës, zgjedhjes dhe sigurisë për konsumatorët, teknologjinë energjetike dhe dimensionin e jashtëm të tregut të brendshëm komunitar të energjisë.³¹

Institucionet e Kosovës sot janë mjaft prapa arritjes së caqeve për zhvillim të burimeve të përtëritshme të para para në Strategjinë e Energjisë 2009-2018. Janë 3 probleme elementare në përmbushjen e këtyre kriterëve: (1)


30 Strategjia e Energjië 2009-2018 parasheh që (i) HC Zhur do të prodhon 398GWh energji elektrike në vitin 2015 (faqe 57 e Strategjisë), (ii) do të prodhoheshin 125 GWh energji elektrike nga hidrocentralet e vogla distributive në 2011, por në fakt u prodhuan vetëm 30.238 GWh sipas "Balanca Vjetore (e Realizuar) e Energjisë e Republikës së Kosovës për Vitin 2011 (<http://mzhe.rks-gov.net>), pra vetëm 24.2% e parashikimit.

31 http://ec.europa.eu/energy/energy2020/index_en.htm

përpjekjet aktuale për të gjeneruar vetëm nga djegia e linjitet për të rritur (e jo zvogëluar për 20%) përdorimin e linjitet pas ndërtimit të TC Kosova e re, (2) mungesa e përpjekjeve serioze për të tërhequr investime private në përdorimin e burimeve të vogla ujore për gjenerim të energjisë elektrike, dhe (3) ngecje e dukshme në krijimin e kushteve për operacionalizimin e tregut të energjisë nga burimet e përtëritshme në Kosovë, për çka mungojnë jo vetëm legjislacioni i kompletuar, kuadri rregullator i përshtatshëm, por edhe insentivat (stimulimet) e duhura³² për investitorët e vegjël privat³³. Ajo që është bërë deri tash është në fushën e legjislacionit, që është duke u kompletuar disi, por në fushat tjera nuk është bërë pothuajse asgjë konkrete. Përndryshe, roli i burimeve alternative fillimisht duhet të jetë rol komplementar, i cili jo vetëm sjell energji të pastër dhe minimizon ndikimet në shëndetin e popullatës dhe në mjedis, por edhe sjell mundësi të mira për përmirësimin e shërbimeve energjetike, në një sfond shumë më të decentralizuar nga përdorimi i energjisë primare. Nëse këto projekte do të fillonin të paktën atëherë kur u fillua të mendohet për perspektivën energjetike të vendit, para 7-8 vjetëve, Kosova do të mund të kishte deri tash një set të fortë përkrahës për investime private në burimet e përtëritshme, si dhe të paktën hidrocentrali i Zhurit do të mund të ishte në shfrytëzim. Por, sot, ky hidrocent-

32 Deri tash, ZRrE ka miratuar tarifa nxitëse për hidrocentralet e vogla dhe energjinë nga era.

33 Ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, në Kosovë mungojnë aktualisht skema të asistencës teknike dhe financiare që mundësojnë përgatitje në nivel të lartë të projekteve investive dhe kreditimin e ndërmarrësve vendor për zhvillim të burimeve të përtëritshme.



tral është vetëm pjesë e retorikës së vendimmarrësve sa herë që janë në presion të publikut për të, por jo edhe pjesë e veprimeve konkrete për ndërtimin e tij.

Prognozat e dala nga studimet e deritanishme për potencialin energjetik ekonomisht të shfrytëzueshëm të vendit nga burimet e përtëritshme thonë se Kosova mund të gjeneron energji nga këto burime: (1) Energji ujore - Zhur 300 MW fuqi me 400 GWh/vit energji, Ujmani 35 MW fuqi me 80MWh/vit energji, dhe Hidrocentralet e vogla HCV) 100 MW³⁴ fuqi me 500MWh/vit energji³⁵; (2) Energji solare për prodhim të energjisë elektrike (në periudhën afatmesme) vlerësohet në rreth 160 GWh/vit³⁶ që mund të arrihet nga një fuqi e instaluar prej 70MW; (3) Energji e erës për periudhën afatmesme vlerësohet indirekt në rreth 2,315 GWh/vit që mund të arrihet me një fuqi të instaluar prej 1,050 MW³⁷; dhe (4) Energjia nga biomasa për periudhën afatmesme, vlerësohet në rreth 119 GWh/vit³⁸. Ndërkohë, mungojnë të dhëna që do të tregonin potencialin nga energjia gjeotermale.

34 Në vitin 2006 MEM identifikoi 18 HCV rreth 64MW fuqi që mund të prodhojnë rreth 300 GWh energji në vit, ndërsa në 2010 MEM identifikoi më tej edhe rreth 40MW kapacitete për HCV me rreth 200 GWh energji në vit.

35 Strategjia e Energjisë 2009-2018, faqe 57, parasheh që prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet e vogla (distributive) të jetë rreth 250 MWh/vit në vitin 2018.

36 Sipas "Kosova – Korniza Rregullatore për Burimet e Përtëritshme të Energjisë (BRE): Procedurat dhe Metodologjia për Caktimin e Çmimit të Energjisë Elektrike nga BRE", tetor 2009, raport i përgatitur nga Mercados, Financuar nga BB.

37 Po aty

38 Po aty.

Kosova sigurisht nuk do të mund të bazohet plotësisht mbi këto burime alternative. Pothuajse nuk ka vend në botë që ka rezerva të thëngjillit, gazit apo naftës që është bazuar plotësisht mbi burime alternative. Por, potenciali i ujit, ai i erës, dhe ai solar janë të mjaftueshëm për ta dinamizuar dukshëm ndryshe ofertën mikse energjetike të vendit, për ta diversifikuar, decentralizuar si dhe për ta bërë shumë më të pastër. Efektet ekonomike të këtij ndryshimi, nëse jo menjëherë, në afat më të gjatë do të kthehen shumëfish te investuesit, dhe konsumatori, sepse tregu global është duke përcaktuar rregulla që përdorimin e fosileve e bëjnë gjithnjë e më të shtrenjtë, aq të shtrenjtë që, nga studimi i Bankës Botërore³⁹ shihet se përdorimi i linjtit në Kosovë sjell gjenerim më të lirë të energjisë elektrike se përdorimi i gazit për këtë qëllim vetëm në kushtet kur çmimi i tregtimit të një ton CO₂ në tregun përkatës Evropian do të jetë më i ulët se 23.25 Euro/tCO₂ të emituar.

Ky fakt implikon një veprim shumë të shpejtë në planifikimin e një "energji-miks" që do të sjell një platformë dinamike të gjeneruesve të energjisë duke përdorur të gjithë potencialin energjetik, me në krye burimet e përtëritshme, jo fosilore. Në këtë kontekst, nuk duhet harruar gazin, nëpërmes të kyçjes në rrjetin e gazit, në pikën më të afërt dhe të përshtatshme, Shkupin, me të cilin Kosova tashmë është e lidhur me një gaz-sjellës nëpërmes të cilit është dërguar gazin termik i prodhuar me gazifikim të linjtit në KEK⁴⁰ gjatë viteve 80-ta. Boksi

39 Raport: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve për furnizim me energji elektrike në Kosovë, Banka Botërore, Dhjetor, 2011, faqe xiii

40 Gazifikimi i linjtit ka prodhuar 400 milion m³N/vit gaz termik,

në vijim është nxjerrë nga një raport i BB, hartuar nga ekipi i firmës së konsulencës DH Infrastructure dhe rishikuar nga punonjësit e Bankës Botërore.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009 - 2018⁴¹ parasheh një sërë masash që duhet aplikuar për të siguruar përdorim të gjërë të burimeve të përtëritshme dhe efikasitet të energjisë që është ngushtë e ndërlidhur me të. Shumë pak është bërë në këtë drejtim, dhe kjo strategji mbetet një dokument i vdekur, më shumë në sirtaret e vendimmarrësve kosovar.

që në mes tjerash është shitur edhe në Shkup


41 <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,204>

Kombinimi më i lirë për furnizim me energji elektrike

Planet për furnizim me energji alternative për Kosovë duhet të përfshijnë një kombinim për plotësimin e ngarkesës bazë dhe të ngarkesës maksimale, si dhe një kombinim të kapaciteteve të termocentraleve dhe të energjisë së ripërtëritshme. Rrjedhimisht, përmes këtij studimi supozohet se do të ndërtohen impiantet vijuese me të tria opsionet për prodhimin e rrymës:

- Hidrocentrali i Zhurit prej 305 MW që ka mjedise të mëdha të ruajtjes dhe do të shfrytëzojë gjatë orëve të ngarkesës maksimale;
- 395 MW të kapaciteteve të instaluar të energjisë së ripërtëritshme (që do të ofronte përafërsisht 170 Më të kapacitetit të qëndrueshëm), dhe
- Përafërsisht 600 MW nga termocentralet.

Burimi: Raport: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve për furnizim me energji elektrike në Kosovë, Banka Botërore, Dhjetor, 2011



5. Mos respektimi i Politikave Energjetike të BE “20-20-20 (2020)”



Çështja e (mos)respektimit të politikave Evropiane për sektorin e energjisë, të dhëna në mënyrë shumë eksplicite në “Politikat e BE 20-20-20”⁴² nuk është më një kriter që “do të duhej” të merret parasysh, kur të ndërtojmë perspektivën tonë energjetike, por që mundemi edhe pa te, sepse nuk jemi vend anëtar i BE-së,

bile as Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit akoma nuk e kemi nënshkruar! Politikat e BE-së për Energjinë deri në vitin 2020 janë paraparë të paktën në 4 dokumente strategjike që duhet t’i respektojmë patjetër: (1) Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE),

(2) Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009 - 2018, (3) Vendimi i MEM, i vitit 2007 për të vendosur cakun prej 7.78% deri në vitin 2016⁴³, për generimin e

42 Qëllimet e BE-se janë inkorporuar në “Strategjia Evropiane 2020 për rritje të mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse”, e adoptuar nga Këshilli Evropian në qershor 2010. Konkretisht, BE-ja synon arritjen e objektivave ambicioze lidhur me energjinë dhe ndryshimet klimatike për 2020: reduktimin me 20% të emetimit të gazeve që shkaktojnë efektin ‘serë’, rritjen në 20% të pjesës që zënë burimet e përtëritshme në prodhimin energjetik dhe përmirësimin me 20% në efikasitetin e energjisë. (<http://ec.europa.eu/energy/strategies/>)

43 Udhëzim Administrativ Nr. 06/2007 “Caqet indikative për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike nga burimet e ripërtëritshme

energjisë nga burime të ripërtëritshme, dhe (4) Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencën e Energjisë - PVKEE 2010-2018 ku parashihet arritja e caktuar prej 9% për rritjen e efikasitetit të energjisë gjatë periudhës 2010-2018. Pra, për një shtet të ligjit do të duhej të ishte mjaft për të përcaktuar “rregullat e sjelljes” në prag të integritetit evropian, familje që ka rregulla dhe të gjithë iu përmbahen.

Pse është bërë shumë pak për të filluar implementimin masiv në terren të këtyre politikave?

I pari obligim që del nga Politikat 20-20-20 të BE-së është të zvogëlojmë (në perspektivë me afërsimin më të afërta) emisionin e gazrave që shkaktojnë efektin e serës, për 20%, që do të thotë se ose duhet: (i) zvogëluar përdorimin e karburanteve me origjinë fosile me 20%, (ii) rritur efikasitetin e termocentraleve dhe Termokosit me 20%, që është e pamundur praktikisht, ose (iii) të punojmë për të arritur një kombinim të dy të parave. Si do të jetë situata karshi këtij obligimi pas vendosjes së kapaciteteve të reja 600Më fuqi, dhe pas ndaljes së punës së TC Kosova A?

Meqenëse viti referent me të cilin do të maten parametrat aktual është viti 1990, kjo do të thotë se në vitin 2020 duhet të djegim përafërsisht 20% më pak linjit se

atëherë. Në vitin 1990 TC-të e Kastriotit kanë djeg rreth 8 milion tonë linjit. Pas fillimit të punës së Kosova e Re,

shme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi”, Ministria e Energjisë dhe Minierave.

me Kosovën B në punë poashtu, pritet që do të djegim 10 tonë linjit që është 25% më shumë. Pra, ky kusht nuk mund të arrihet me strategjinë aktuale të qeverisë.

Obligimi i dytë është të rrisim prodhimin e energjisë nga burimet e përtëritshme për 20%, që do të thotë se do të duhej të fillojnë punë deri në vitin 2020 hidrocentralet, feramat solare, turbinat e erës etj. Për një kërkesë totale për energji të paraparë (me ekstrapolim bazuar në kërkesën e paraparë prej rreth 7,000 GWh për vitin 2018, për skenarin e mesëm zhvillimor, në Strategjinë e Energjisë 2009-2018) prej rreth 8000 GWh në vitin 2020 do duhej të prodhohen prej BRE-ve 20%, pra rreth 1600 GWh. Nëse mendohet se kjo energji nga BRE-të do të kërkohej të mbulohej nga burimet vendore, atëherë një skenar i mundshëm do të ishte që në vitin 2020 BRE-të të kontribuonin si vijon: HC Zhur me rreth 400 GWh, Hidrocentralet e vogla me rreth 400 GWh, Era me rreth 700 GWh, dhe dielli e biogazi me rreth 100 GWh. Për ta arritur këtë objektiv na duhet që të paktën të ndërtojmë dhe lëshojmë në punë hidrocentralin e Zhurit që e kemi në planet tona, por asgjë konkrete akoma nuk jemi duke bërë në këtë drejtim.

Ngritja e eficiencës së energjisë për 20% është sfidë e madhe. Jemi të parët në Ballkan, të paktën, për nga nivelin e humbjeve enorme komerciale dhe teknike⁴⁴, të cilave


44 Sipas ZRrE në raportin "Siguria e furnizimit për Kosovë (energji elektrike, gazi natyror dhe nafta), korrik 2011, humbjet komerciale ishin 24%, dhe ato teknike 17% në rrjetin e distribucionit dhe 2% në rrjetin e transmetimit (ose rreth 2,000 GWh) të energjisë së prodhuar.

s'po mund t'i dalim në krye me vite. Jashtë kësaj, eficienta nuk është e mbështetur me instrumente universale stimuluese: fiskal, përmes politikave që mundësojnë lehtësime doganore dhe të tjera gjatë importit të teknologjive eficiente, apo edhe tarife. Në pajtim me kërkesat e TKE-së, është bërë përparim me plotësimin e kornizës ligjore dhe për eficiencën e energjisë, përfshirë ligjin për Eficiencë të Energjisë, por mbetet që të funksionalizohet Age

incia për Eficiencën e Energjisë dhe krijohet një Fond për eficiencën. Mbështetje po japin BE dhe Qeveria Gjermane (nëpërmjet KfW) duke financuar projekte publike demonstrative për eficiencë dhe siguruar nëpërmjet disa bankave komerciale vendore financime të masave për rritje të eficiencës së energjisë në sektorin amvisnor dhe të NVM-ve.

Ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë kemi obligime të shumta dhe konkrete. Këtë Traktat e kemi nënshkruar në vitin 2005⁴⁵, dhe ekziston ndërlidhja direkte e detyrueshme e jona me obligimet që dalin nga legjislacioni, politikat dhe strategjitë e BE-së në këtë sektor. Pra, nuk mund të themi me kollaj se nuk jemi anëtarë të BE dhe *aquis* e saj nuk na obligojnë fare që t'i përmbahemi, përkundrazi duhet të thuhet se për sa i përket sektorit tonë të energjisë, *acquis* të BE-së për energjinë, mjedis dhe konkurrencë janë të detyrueshme, me disa përjashtime për afate kohore të zbatimit të disa direktivave të BE-së!

45 www.energy-community.org/



Në portfolion e gjenerimit të këtij Traktati, Kosova është zotuar në rritjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e përtëritshme.

Shënim:

Përlogaritje paraprake për nivelin e konsumit të linjtit nga termocentralet në vitin 2020

TC Kosova e Re (me dy blloqe me fuqi nominale 300MW secili)

600 MW Bruto, 560MW Neto

7,500 orë pune në vit, dhe harxhim të linjtit 1.1ton/MWh

Energjia vjetore: $560\text{MW} * 7,500 \text{ orë/vit} = 4,200,000 \text{ MWh}$

Konsumi i linjtit: $4,200,000 \text{ MWh} * 1.1 \text{ ton/MWh} =$

$4,620,000 \text{ ton} = \mathbf{4.64 \text{ milion ton}}$

TC Kosova B pas rehabilitimit:

660 MW Bruto, minimum 600MW Neto (sipas studimit për rivitalizim të USAID)

7,500 orë pune në vit, dhe harxhim të linjtit 1.2ton/MWh

Energjia vjetore: $600\text{MW} * 7,500 \text{ orë/vit} = 4,500,000 \text{ MWh}$

Konsumi i linjtit: $4,500,000 \text{ MWh} * 1.2 \text{ ton/MWh} =$

$5,400,000 \text{ ton} = \mathbf{5.4 \text{ milion ton}}$

Totali i harxhimit/djegies së linjtit në termocentrale në vitin 2020 = **10 milion ton**

6. Mos përgatitja e mirë e kërkesës për projekte investive (tenderit ndërkombëtar)!



Përgatitja e projekt-propozimeve për investime kapitale kërkohej të bëhet jo vetëm në përputhje me disa norma ndërkombëtare, por edhe në përputhje me kushtet e vendit ku do të realizohen ato. Mbajtja parasysh e parimeve bazë të ekonomisë së tregut, sidomos parimit që çmimet vendosen në treg dhe jo nga qeveria në marrëveshje me investitorët privat, përbën kusht parësor të domosdoshëm për sukses.

Dizajnimi dhe formulimi i projekteve të mëdha investive kërkon jo vetëm aftësi dhe ekspertizë, por edhe angazhim shumë-institucional dhe pjesëmarrje të akterëve relevante jo-qeveritar përfshirë shoqërinë civile. Projektet investive të mëdha që nuk konsiderojnë zërin e akterëve vendor janë të pakta. Edhe ato që kanë aritur të realizohen kanë rezultuar me probleme në shumicën e rasteve; prandaj edhe janë rishikuar dhe ri-negociuar në tërësi. Këtë e tregon eksperiencia me të tilla projekte në Afrikë, Amerikën Latine, Azi e kudo. Këtë e dëshmojnë edhe projektet apo privatizimet e sektorit energjetik në vendet përreth Kosovës, përfshirë Shqipërinë. Specialistët dhe ekspertët vendor janë mjaft të aftë të mar-

rin pjesë aktive të rëndësishme në dizajnin, formatimin dhe përgatitjen e dokumenteve për tenderët e mëdhenj të investimeve në sektorin energjetik. Çështja është se institucionet tona nuk kanë besim në aftësitë e njerëzve tanë. Kjo mendësi duhet të harrohet. Kërkohej që proceset e përgatitjes së projekteve kapitale t'i drejtojnë specialistët dhe institucionet tona, pa mohuar ndihmën dhe ekspertizën e huaj që duhet të luajë rolin e vet të rëndësishëm.

Disa nga arsyet pse tenderët e mëdhenj ndërkombëtar për sektorin energjetik, me fokus në projektin Kosova e Re, kanë dështuar mund të përmbledhen si vijon:

1. Formulimi i projektit me shumë komponentë (termocentrali i ri, mihja e re dhe rivitalizimi i TC A në pakon tenderuese të vitit 2006, dhe më pas në 2009, përfshirja e rehabilitimit të TC B pasi ishte hequr TC A nga ajo pako) dhe lidhje të komplikuar mes tyre gjatë shfrytëzimit (kontratat afatgjata me çmime fikse). Kështu krijohet monopoli në gjenerim të energjisë. Gatishmëria e Qeverisë për ta dhënë me këtë tender edhe të gjithë fushën e Sibovcit ishte jo e arsyeshme dhe krijonte praktikisht edhe një tjetër monopol në mihjen e linjitit.
2. Përdorimi i drafteve “shabllonë” të përdorura më herët nga këshilltarët e huaj për projekte në vende të tjera në zhvillim, duke ndërruar emërtimet dhe datat, por pa reflektuar sa dhe si duhet për të akomoduar *acquis* të BE-së sa i takon energjisë dhe konkurrencës.
3. Baza ligjore për projekte të mëdha investive fillimisht ka munguar, por më tej është hartuar dhe miratuar. Ligji për Miniera dhe Minerale mungonte, ndërsa Ligji për


Partneritete Publiko Private u miratua në mesin e vitin 2009⁴⁶. Procesi për Projektin Kosova e Re filloi në vitin 2006⁴⁷, pra kur baza ligjore ishte jo e plotë. Procesi tenderues për Termocentralin Kosova e Re me shumë gjasa do të rifillohet, dhe tashmë ekziston⁴⁸ baza ligjore kryesore me të cilën do të procedohet.

4. Mos-angazhimi i të gjithë faktorëve relevante vendor në proceset e përgatitjes së projekteve, për aq sa është e nevojshme për arritjen e një konsensusi sa më të gjerë mes aktorëve vendor. Anashkalimi i Kuvendit dhe angazhimi i tij vetëm kur kërkohej miratime si ai për të futur TC B në pakon tenderuese dëshmon se roli mbikëqyrës i Kuvendit nuk është ushtruar si duhet.

46 Ky Ligj që u përgatit vetëm nga ekspertë të huaj të cilët nuk arritën të njohin realitetin vendor dhe Evropian, dhe që nuk konsideruan eksperiencën dhe praktikën më të mira në arritjen e partneriteteve të suksesshme ‘ëin-ëin’, u zëvendësua me një tjetër ligj për partneritete publiko private në vitin 2011.

47 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me Vendimin Ekzekutiv Nr. 2006/6 të 17 mars 2006, ka mandatuar krijimin e Komitetit Drejtues të Projektit (KDP) dhe krijimin e Zyrës Projektit për Projektin e Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti (LPTAP). Detyra e caktuar për KDP ishte vetëm të menaxhonte/mbikqyrte mbarrëvajtjen e LPTAP sipas termave të referencës (ToR) të miratuara nga Banka Botërore. Në këto ToR nuk cilësohen përgjegjësitë që KDP-ve sot u caktohen në ligjin për partneritete publiko privat.

48 Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185, Neni 14.2.8. parashikon që ZRrE ka autoritetin dhe përgjegjësinë “të ushtrorë aktivitetet e përcaktuara në nenin 39 për iniciimin dhe ushtrimin e procedurës së tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike.” Ky ligj ndërlidhet me Ligjin për PPP duke e plotësuar bazën më të domosdoshme ligjore për arritjen e partneriteteve publiko private në projekte të gjenerimit të energjisë.



7. Vonesat e mëdha në ndërtimin e hidrocentralit Zhur



Ndërtimi i HC Zhur është ide e kahershme. Studimet e para janë kryer aty nga vitet '80. Studimet janë rishikuar disa herë, për të arritur në atë më të fundit të financuar nga Banka Botërore dhe të përfunduar në qershor vitin 2009. Rezultatet e këtij studimi treguan se HC Zhur ia vlen të ndërtohet⁴⁹. Pse nuk po avanco-

het pra?

Në vitin 2009 MEM, me pak konsulentë edhe nga USAID, finalizoi përgatitjen e dokumenteve bazë për fillimin e procesit për tenderimin e ndërtimit të HC Zhur. Gjatë vitit 2010, u krijua edhe Komiteti Drejtues i Projektit. Në qershor 2010 u kërkuar ofertat dhe në gusht të po atij viti u përzgjedhën tri kompani/konsorciume të huaja⁵⁰.

Në vitin 2011 procesi u pezullua nga MZHE me arsyetimin se duhet të rishikohej fisibiliteti i projektit. Pas rreth një viti u arrit përsëri në konkluzion se projekti është fizibël, dhe vetëm kaq. Askush nuk di te thotë se çfarë pritet për të vazhduar procedurën për tenderimin e këtij hidrocentrali.

49 HC Zhur parashihet të ketë kapacitet të instaluar prej 305 MW, prodhim mesatar vjetor prej 400 GWh/vit, dhe kërkon një investim kapital prej 330 milion Euro për ndërtim të tij.

50 Të përzgjedhurit janë: Kelag (A), Limak (TR), İnşaat (TR) & D Energy (UK)

Ajo që është vërejtur vitet e fundit është se ka pasur qëndrime të ndryshme mes Prishtinës dhe Tiranës rreth ndërtimit të HC Zhur. Kjo rezultoi në këtë qenë arsyeja përse nuk është proceduar më tej ky projekt.

Duhet theksuar se Kosova dhe Shqipëria duhet t'i rregullojnë marrëdhëniet ndërshtetërore sa i takon ujërave kufitar në kuadër të traktateve dhe praktikave ndërkombëtare. Këtu është dashtë të fillohej diskutimi mes dy shteteve dhe puna që prej vitit 2010⁵¹. Por, Qeveria e Kosovës nuk është treguar aktive dhe e interesuar sa duhet që procesi për këtë hidrocentral të rëndësishëm të avancohet.

Ndërkohë, në Shqipëri ka filluar ndërtimi i disa hidrocentraleve të vogla të cilat do të furnizohen me ujë nga lumenjtë që parashihet të mbushin dy rezervuarët e ujit të parapara për HC Zhur. Ky fakt e komplikon procesin. Situata do të ishte ndryshe po që se Qeveria e Kosovës do të kishte proceduar pa ndërprerje procesin e tenderimit të HC Zhur. Tashmë mbetet që shpejt të studiohet situata dhe të trajtohet ajo me kompetencë dhe me nivelet më të larta të Qeverisë Shqiptare. Kjo është e mundur, por kërkon angazhim nga Qeveria e Kosovës, si dhe përgatitje serioze të një ekipi kosovar për të negociuar, sidomos sa i takon të drejtave për ujërat rrjedhëse ndërkufitare.

MZHE duhet të ketë një qëndrim të qartë rreth këtij projekti dhe të drejtë procesin. Ky projekt është pjesë e

51 Gjatë periudhës 2009-2011 ka pasur kontakte në nivel të ministrave të dy vendeve lidhur me këtë çështje, por pa rezultate konkrete.

rëndësishme e Strategjisë Energjetike të miratuar nga Kuvendi, dhe nëse MZHE arrin në përfundim se nuk mund të arrihet ndërtimi i tij, atëherë duhet ta nxjerrë një vendim përkatës të Qeverisë dhe t'ia përcjellë atë Kuvendit të Kosovës.

8. Injorimi i interesit ekonomik të vendit në investimin në TC Kosova e re




Pjesa më e madhe e debatit për termocentralin e ri ishte koncentruar rreth problemeve mjedisore që do të paraqiteshin dhe implikimeve të shumta që një mjedis i rrënuar nga termooenergjetika ka në cilësinë e jetës së qytetarëve, sidomos atyre që jetojnë shumë afër termocentraleve, përfshirë këtu edhe Prishtinën. Aspek-

te dhe çështje tjera të shumta që dalin nga një investim i tillë u diskutuan fare pak, apo aspak. Një aspekt shumë i rëndësishëm për investimin, që nuk u diskutua dhe as që u kuptua sa duhet, ishte interesi ekonomik i vendit në këtë investim të madh.

Janë disa çështje që është dashur të gjejnë vend jo vetëm në diskurs publik, por edhe në agjendat e atyre që e udhëhoqën përgatitjen e këtij projekti madhor investiv, të cilat mund të përmbliidhen në pyetjen: Cili është inter-

esi ekonomik i vendit në këtë investim? E zbërthyer, kjo pyetje do të mund të vihej në disa segmente: (1) Cila (sa përqind) do të ishte pjesëmarrja e Kosovës në këtë investim të formës së partneritetit publiko privat? (2) Si do të ekonomizonim sa më mirë me linjitin dhe mihjet sipërfaqësore? (3) Cila do të jetë pozita e TC-së së re brenda kompleksit ekzistues (atij gjenerues dhe ai i mihjeve)? dhe (4) Si ta evitojmë monopolin në sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike, dhe si t'i stimulojmë aktorët tjerë të bëhen pjesë e tregut të lirë të tregtisë me shumicë të energjisë elektrike, fillimisht brenda Kosovës e pastaj brenda rajonit? Gjykuar nga veprimet e ndërmarra, që reflektoheshin qartazi në tenderët e shpallur për Projektin Kosova e Re, interesi ekonomik i vendit ishte lënë shumëfish pas dore.

Investimin në TC të reja e kishin përgatitur kryekëput këshilltarët e transakcioni të BB, BE dhe USAID. Parimi themelor të cilit duket se ata i janë përmbajtur është që të studiohet gjithçka që duhet për t'i njohur më mirë kushtet konkrete brenda të cilave do të operonin investitorët e huaj, dhe të gjinden modalitete kryesisht teknike për t'i joshur sa më shumë investuesit potencial. Poashtu, janë bërë edhe studime mjedisore dhe sociale, të cilat ishin bërë sa për sy e faqe (sepse duheshin bërë sipas procedurave të BB) dhe jo edhe për tu ndihmuar me gjetjet e këtyre studimeve për ta dizajnuar dhe paketuar sa më mirë TC-në e re. Por, studime ekonomike, që do të elaboronin se cili është ai skenar që mbron më së miri interesat tona ekonomike, nuk ishin bërë ose të paktën nuk u prezantuan kurrë!



Janë tri probleme të mëdha që vazhdimisht e përcollën përgatitjen e tenderëve: (1) Fillimisht nuk parashihej fare që Kosova të ketë pjesëmarrje në mihjen dhe gjen-erimin e rrymës, e më vonë, në tenderin e dytë, është paraparë një pjesëmarrje minimale, por larg vlerës reale që do të duhej të kishte (2) Potenciali prej gati 1 miliard ton linjit i lihej në dispozicion të plotë investitorit, te tenderi i parë, dhe më vonë në tenderin e dytë është zvogëluar kjo sasi në aq sa do të jetë e nevojshme për të operuar me TC-në e re në 40 vjetët e ardhshme (3) Krijohet një monopol brenda tregut energjetik Kosovar pasi që investitorit të ri i ipej edhe i tërë kapaciteti ekzistues termoenjergjetik (Kosova B) Ky skenar është ngatërruar paksa kohëve të fundit, edhe pse një vendim të tillë e ka marrë edhe Kuvendi i Kosovës.

Sikur edhe te privatizimi i aseteve tjera publike, edhe gjatë përgatitjes së tenderëve për TC-në e re, në asnjë moment nuk është dalë para qytetarëve me një llogari të qartë se çka dhe sa do të fitojmë pas këtij investimi, të cilin do të duhet ta bëjmë me shumë sakrifica jo vetëm ekonomike, por edhe mjedisore, shëndetësore, demografike dhe makro-ekonomike. Një llogari që u prezantua në vitin 2006⁵² thoshte se fitimi do të jetë pothuajse neglizhues - rreth 150 milion euro, duke futur në të pagat e punëtorëve Kosovar, tatimet, taniemat për thëngjill, dhe fitimin e kompanive kosovare të sub-kontraktuara. Studimi i vitit 2012 i BB⁵³ thotë se vetëm ko-

stoja mjedisore e punës së TC-ve në Kosovë është nga 300-500 milion në vit. Pra, do të fitonim 150 milion dhe do të humbim mesatarisht 400 milion me punën e TC-ve, sepse aq kushtojnë dëmet që vijnë nga këto TC.

Kosova ka dekada të tëra që punon me TC. Ekonomia e punës së tyre njihet shumë mirë nga ekspertë kosovar. Nuk e kemi fare të vështirë të llogarisim se cili do të jetë fitimi nga puna e një TC-je. Pse pra nuk është dalë kurrë para qytetarëve të ju thuhet se termocentrali i ri do të na sjell këto përfitime, në rast se shkojmë pas këtij skenari, apo pas ndonjë skenari tjetër? Është punë e lehtë fare për ekspertë. Paguam nëpërmjet granteve të BB, BE, dhe USAID dhe vazhdojmë të paguajmë tani nga Buxheti i Kosovës miliona euro për këshilltarë ndërkombëtar të transaksionit, që sigurisht e dinë mirë se cili do të ishte skenari ekonomik më fitimprurës edhe për Kosovën (jo vetëm për investitorin privat), por asnjëherë nuk e morëm vesh një gjë të tillë. Pse na lënë me dyshime, se diçka po zihet me këto skenarë? Pse duam t'i përsërisim skenarët e ndërtimit të "Rrugës së Kombit", ku mungesa e transparencës hodhi hije të rëndë mbi këtë investim.

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë prej vitit 2005⁵⁴, ideja kryesore e të cilit është të promovoj tregun e lirë rajonal të energjisë i cili do të mund të integrohet tërësisht në të ardhmen në tregun Evropian. Të jesh në treg të lirë do të thotë të punosh duke respektuar rregullat e tij, ku një nga kryesoret është të evitosh krijimin e monopoleve, që mbysin konkurrencën dhe me të edhe të gjitha vlerat e një tregu

54 www.energy-community.org/

52 Sipas Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Zyra e Projektit PATEL

53 World Bank Kosovo, Development and Evaluation of Power Supply Options for Kosovo 2011

të lirë liberal. Por, edhe përkundër faktit që Kosova vazhdon të merr pjesë aktive në mbajtjen gjallë të këtij Traktati, që është e vetmja lidhje me *Acquis* Europiane, ajo në disa raste e ka favorizuar paraqitjen e monopolit: kur vendosi që TC Kosova B t'i ipet pronarit privat që do ta fitonte tenderin për të ndërtuar TC Kosova e Re, si dhe kur Qeveria e shiti distribucionin dhe furnizimin e energjisë. Me këtë veprim janë thyer disa ligje Kosovare, Evropiane dhe Ndërkombëtare⁵⁵.

Përveç monopolit që favorizohet si në gjenerim ashtu edhe në furnizim, vendimmarrësit tanë kanë pasur problem permanent me caktimin e pjesëmarrjes Kosovare në investimin e ri. Filloi me zero përqind në vitin 2006 kur synoheshin 2,100 MW, nëpërmes të 5% në vitin 2008-2009, e deri te diku 25% i deklaruar në fund të vitit 2010⁵⁶. Pra, një progres i vazhdueshëm tregon se klasa politike ka filluar nga pak të kuptoj se cili do të duhej të ishte interesi kombëtar në këtë investim, por akoma është larg për të arritur te kriteret që do të duhej të ishin definuese për të caktuar këtë pjesëmarrje.


Nëse qytetarët e Kosovës janë të dënuar që edhe në shumë dekada të ardhshme të thithin ajër të ndotur, atëherë do të duhej ta dinin çmimin që ndotësit do të duheshin ta paguajnë për këtë. Ky çmim, në studimin e BB, për Eksternalitet është rreth 400 milion euro në

55 Forum 2015, Hallka me e dobët, Aksham Pazari i Aseteve Publike, Shtator, 2010

56 Pas kërkesave të shumta nga KDP dhe këmbënguljes së Ministres së Energjisë që pjesëmarrja e Kosovës mund dhe duhej të rritej ndjeshëm, këshilltarët e transaksionit mbështetën rritjen deri në 25-30% të pjesëmarrjes së Kosovës në Projektin Kosova e Re.

vit, dhe vështirë mund të kompensohet. Por, të paktën duhet qëndruar konsistent ndaj një vlere minimale që duhet ta mbajmë për vete në këtë investim, për të minimizuar rolin e dëmshëm të punës së TC-ve në të ardhmen. Ajo që vazhdimisht nuk merret parasysh kur e caktojmë përqindjen e pjesëmarrjes Kosovare në TC-të e reja është: (1) tregu (monopoli i dhuruar), kur investuesit i garantohen afër 400,000 konsumatorë (praktikisht furnizimi i të gjithë popullatës dhe bizneseve) - pra i ipet tërësisht treg vendor për shitjen e prodhimit, duke ia garantuar atë edhe me kontrata të posaçme afatgjata (2) i garantohet linjiti i lirë, për të cilin do të paguhet një tantieme vetëm dhe (3) i ipet një infrastrukturë e zhvilluar tashmë brenda zonës së operimit të TC-ve ekzistuese, përfshirë këtu mihjen e re të Sibovcit Jugperëndimor, për të cilën ishin paraparë rreth 350-400 milion Euro investime dhe tashmë janë pothuajse kryer⁵⁷. Pra, në një mënyrë i garantohet monopoli mbi të gjitha.

57 Gjatë periudhës 2008-2010, sipas raportit të auditorit të jashtëm të KEK-ut për vitin 2011, Qeveria i ka dhënë hua KEK-ut 203 milion Euro për zhvillimin e mihjes se re të Sibovcit Jugperëndimor. Investimet e tjera në këtë mihje janë financuar nga burimet vetanake të KEK-ut, donacione nga Komisioni Evropian, dhe ato nga Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW.



9. Privatizimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike



Privatizimi i shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike ishte paraparë fillimisht në Strategjinë e Energjisë 2006-2015, Qasja në atë strategji ishte që në përputhje me *acquis* të BE-së, shërbimi i furnizimit të ndahej ligjërisht nga ai i shpërndarjes dhe të fillohej procesi i privatizimit nëpërmjet disa projekteve

pilot ku furnizimi i energjisë dhe sidomos inkasimi do t'i kalohej sektorit privat (nënkuptohej kryesisht angazhimi i sektorit privat vendor). Askush nuk e kundërshtoi atë qasje, as ndërkombëtarët që e mbështeten atë strategji, por askush nuk e shtyu procesin që ajo qasje të fillonte të zbatohet. Kjo qasje kishte të mirën se në rrugën drejt decentralizimit do të krijonte mundësi që aktorët vendorë kryesorë (konsumatorët dhe biznesi privat) do të ndërvepronin për të realizuar me sukses procesin e shit-blerjes së rrymës, pra humbjet komerciale do të ishin minimalizuar njëherë e mirë në kushtet e ekonomisë së tregut dhe në përputhje me *acquis* të BE-së.

Qasja për trajtimin e sistemeve të shpërndarjes dhe furnizimit të rrymës u ndryshua (kuptohet edhe nën ndikimin e këshilltarëve të huaj) në Strategjinë e Energjisë për periudhën 2009-2018, strategji që miratuar nga

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo strategji parasheh angazhimin e sektorit privat në shpërndarjen e energjisë elektrike shprehimisht si vijon:

“Krijimi i kushteve për një treg pa monopol të energjisë elektrike në Kosovë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë (TKE), përbën qasjen e Qeverisë për tërheqje të investimeve për të siguruar çmime sa më të favorshme të energjisë për konsumatorët”.

Poashtu, në Strategji thuhet se *“Avancimi i mëtutjeshëm dhe investimet e reja janë të domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes për të zvogëluar humbjet...”*. Pra, përkthyer në një gjuhë eksplicite, kjo do të thotë se Kuvendi i Kosovës nuk duhet të miratojë përfundimisht pakon e privatizimit të distribucionit nëse Qeveria nuk garanton se paketa e privatizimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit ashtu siç është finalizuar i siguron dy gjëra: (1) Eliminimin e monopolit në furnizimin e energjisë, duke u akorduar me kriteret e dhëna në *Acquis* për energjinë dhe konkurrencën të BE-së, dhe (2) që investimet e reja të kryhen në atë masë që t'i sjellin humbjet teknike në rrjet në nivelet Evropiane sa më shpejt të jetë e mundur.

Investimet duhet të mos mbulohen paraprakisht menjëherë nga tarifat, por tarifat të mbulojnë gradualisht investimet e kryera sipas një plani investimesh (të përgatitur paraprakisht nga Qeveria dhe të dakorduar më pas me investitorin privat) që do duhej të ishte pjesë e pakos së privatizimit. Që të reduktohen ndjeshëm sa më shpejt humbjet teknike në rrjet, investimet private

kërkohen më së shumti në vitet e para pas privatizimit, por kjo nuk pritet të ndodhë, sepse çmimet e energjisë për konsumatorët do të rriteshin shumë, dhe kjo duket qartë nga leximi i Nenit 4.14 i marrëveshjes së privatizimit nënshkruar nga Qeveria me investitorin privat në 17 tetor 2012. Ky nen parasheh: “KEDS. Blerësi dhe Investitori, dakordohen kolektivisht të investojnë 300 milion Euro gjatë periudhës 15-vjeçare duke filluar prej Datës së Plotësimit⁵⁸, me kusht gjithnjë që ZRrE të ketë dhënë miratimin e saj dhe aprovon përfshirjen e ndikimit të këtyre investimeve në tarifën relevante të Biznesit të KEDS.”⁵⁹

Më tej, Strategjia e Energjisë 2009-2018 vazhdon: *“Për shkak të faturimit dhe inkasimit të dobët dhe nevojës së skajshme për investime kapitale, Qeveria ka vendosur që Divizioni i Shpërndarjes së KEK sh.a. duhet të privatizohet.....”* dhe me tej:

“Qeveria është zotuar në privatizimin e KEK Shpërndarjes, mundësisht përmes shitjes së aksioneve të saj, tek një investitor privat strategjik nëpërmjet një procedure ndërkombëtare konkurruese të tenderimit. Shitja e KEK Shpërndarjes tek një investitor i fuqishëm me mbështetje financiare jo vetëm që do të ndihmonte në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët dhe zvogëlimin e barrës së Buxhetit të Kosovës, por edhe do të mundësonte investime substanciale kapitale të

58 Data e plotësimit të kalimit të KEDS tek investitori privat


59 Kosovo Electricity Distribution and Supply Privatisation – Implementation Agreement, October 17, 2012

domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë.”

Termi ‘Shpërndarje’ sipas ligjit në fuqi dhe sipas *acquis* të BE-së nuk e përfshin shërbimin e furnizimit; he kjo duhet të ishte saktësuar⁶⁰. Shërbimi i furnizimit nuk do duhej të ishte pa disa kushte pjesë e pakos për privatizimin e KEDS; dhe monopoli në Furnizim të lejohej vetëm për periudhën e mbetur deri në vitin 2015, jo vetëm sepse kështu parasheh TKE-ja, por dhe sepse vetëm kështu krijohen mundësitë reale për hapjen e tregut të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë në Kosovë⁶¹. Për të eliminuar mundësinë e monopolit nga paketa e këtij privatizimi strategjik, përpara se ta miratojë Kuvendi i Kosovës, për marrëveshjet e nënshkruara për KEDS do të ishte e domosdoshme të shprehej zyrtarisht dhe publikisht Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe/ose Komisioni Evropian, ata që monitorojnë apo kontrollojnë plotësimin e *acquis* për energjinë në Kosovë. Për më tepër, Kuvendi duhet të verifikojë paraprakisht nëse parashikimet e Strategjisë të Energjisë 2009-2018 që lidhen me Distribucionin janë zbatuar

60 Neni 2.1.4 i Ligjit për Energji, Nr. 03/L-184, parashikon: “Shpërndarja - transportin e energjisë elektrike, gazit natyror apo ngrohjes në linjat e sistemit të shpërndarjes, apo në sisteme apo tubacione lokale apo rajonale, me synim të dërgimit dhe shitjes të konsumatorët duke mos përfshirë furnizimin.

61 Në rastin më të mirë, ZRrE do duhej të shprehej se në vitin 2015 do të zhvillonte tender të hapur për licencën e Furnizimit Publik (Supplier of Last Resort), të cilën do ta fitonte ofertuesi më çmim më të lirë për kategorinë e konsumatorëve që nuk do të dëshirojnë/munden ta blejnë energjinë në treg prej vitit 2016.



plotësisht. Duket se ato nuk janë zbatuar, dhe Kuvendi nuk duhet të shkelë vendimet e veta të sjella më herët kur ka miratuar Strategjinë e Energjisë 2009-2018.

Pjesëtar dhe katalizator i gabimeve në procesin e privatizimit të distribucionit është edhe IFC, pjesë e Grupit të Bankës Botërore. Pas kërkesë nga disa akter vendor, Ombudsmani i Grupit të Bankës Botërore ka nisur një investigim mbi përputhshmërinë e mandatit dhe rolit të IFC në procesin e privatizimit të KEDS⁶². Rezultatet e këtij investigimi akoma nuk dihen, por ato nuk do të bëhen pjesë e errësirës që ka shoqëruar proceset deri tash.

Çmimet e energjisë elektrike do të rriten patjetër brenda vitit që vjen. Konsumatorët do të duhet të paguajnë, të paktën çmimin që i garanton investuesit profitin e prituri ose më mirë të themi, të pretenduar nga investitori privat që do të paguajë vetëm 26.3 milionë Euro për privatizim të aseteve qindra milionëshe.

Janë disa arsye pse mund të themi se proces i privatizimit të KEDS është i dështuar:

Çmimi vetëm 26.3 milion Euro⁶³, sa rreth 1/10 e një

62 WB Compliance Advisor Ombudsman, OMBUDSMAN ASSESSMENT REPORT, Complaint Regarding IFC Advisory Services Kosovo KEK project (#29107), January 2012. http://www.cao-ombudsman.org/documents/KEKAssessmentReport_ENG.pdf

63 Më shumë gjasa një shumë e ngjashme do të shkon nga Buxheti i Kosovës subvencion për importim të energjisë elektrike për dimrin 2012-2013.

çmimi të arsyeshëm. Mund të flasim për falje strategjike të asteve të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, por jo për një privatizim të mirëfilltë strategjik që synon përmirësimin e shërbimit për konsumatorët.

Vetëm investimet kapitale pas vitit 2000 dhe ato në vazhdim në rrjetin e distribucionit janë shumë herë më të mëdha se çmimi i privatizimit.

Me këtë mënyrë privatizimi lejohet të krijohet praktikisht monopol i plotë në sektorin e furnizimit të energjisë elektrike. Kjo ndodh në një kohë kur Kosova është e obliguar që deri në vitin 2015 ta ketë liberalizuar plotësisht tregun me pakicë të energjisë elektrike. Në kushtet që krijohen me këtë privatizim të shërbimit të furnizimit sot, shanset praktike janë gati zero që kompani të tjera të mund të futen dhe konkurrojnë në këtë sektor për shumë viteve edhe pas vitit 2015.

Pas vitit 2015, sipas kushteve të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, do të duhet që çmimet të jenë të liberalizuara, pra të mos ketë tarifa fikse që aktualisht vendosen nga ZRrE, përveç çmimeve për konsumatorët e vegjël që nuk do dëshirojnë apo munden ta blejnë energjinë e tyre në treg. Praktikisht më të mira përëndimore janë ato që e zgjedhin periodikisht me tender konkurrues atë që do të shesë energji kësaj kategorie të konsumatorëve. Modeli i zgjedhur dhe i kopjuar i këtij privatizimi është dëshmuar i dështuar tashmë në Shqipëri. Më keq akoma, pretendimi i Qeverisë se do të eliminohen menjëherë subvencionimet për import të

energjisë elektrike nuk është relevant. Një veprim i tillë do të kërkonte rritjen e ndjeshme të menjëhershme të tarifave të energjisë, duke i bërë ato gati të papërbalueshme për shumë konsumatorë. Kjo do të çonte në uljen më tej të inkasimit, rritjen e çkyqjeve dhe shtimin enorm të pakënaqësisë së popullatës ndaj Qeverisë. Por, kjo nuk pritet të ndodhë në praktikë po t'i referohemi Nenit 3.1.6(a) të Marrëveshjes së Privatizimit të KEDS, i cili parasheh indirekt që Qeveria do të subvencionoj import të energjisë nga KEK.

Praktika e gabuar në vendet e tjera të rajonit dhe që do të zbatohet edhe në Kosovë është që investimet e premtuara do të bëhen nëpërmjet rritjes së tarifave, pra do të rriten tarifat njëherë dhe pastaj rritja e tarifave do të shkojë për financim të investimeve, dhe jo e kundërta siç do duhet të jetë. Kjo mënyrë e financimit të investimeve, veç humbjeve të tjera, do mund të shoqërohet me ulje të mëtejshme të inkasimit, sepse konsumatorët do të përballen me tarifa më të larta për të njëjtën cilësi të keqe të furnizimit. Nëse do të ndodhte e kundërta, atëherë inkasimi mund të rritej në vijim të përmirësimit të cilësisë së furnizimit si rezultat i investimeve private në sistemin e shpërndarjes sipas një plani të dakorduar paraprakisht.


10. Mungesë e një vizioni afatgjatë zhvillimor për energjetikën?



Progresi i vogël dhe dështimet e mëdha në zhvillimin e sektorit energjetik dëshmojnë për një mungesë vizioni të duhur dhe të qartë të institucioneve tona. Edhe pse shpesh nëpër politika e strategji, por edhe nëpër fjalime dhe diskutime të drejtuesve të institucioneve vendim-marrëse shkruhen dhe dëgjohen se

Kosova është e angazhuar që të zbatoj qasjen e tregut të lirë, *acquis* të BE-së, dhe praktikën më të mira ndërkom-bëtare, këto shumë pak shihen të materializohen në dizajne dhe dokumente tenderuese të projekteve investive dhe aq me pak të zbatohen në praktikë. Thjesht, shkruajmë apo shpesh na e shkruajnë politikën dhe strategjinë të huajt, miratojmë pa lexuar çfarë, dhe nuk i futim në sirtar për t'i zënë pluhuri. Kjo qasje duhet të ndryshohet urgjentisht.

Kosova ka nevojë për mobilizim të kapaciteteve intelektuale vendore që për sektorin e energjisë, në mjaft aspekte, i ka të nivelit të mirë krahasuar me ekspertizën e huaj. Kosova ka nevojë që institucionet relevante ta kenë të qartë rolin që duhet ta luajnë dhe ta luajnë atë me dhe duke mbajtur përgjegjësi. Deri tani duket



se askush nuk mban përgjegjësi për asgjë, për asnjë vonesë, për asnjë dështim, për asnjë paaftësi të dëshmuar. Pse kështu? A dëshmohej kështu se jemi të aftë të avancojmë në rrugën tonë të shtet formimit dhe integritit në BE? Për sektorin energjetik. Po të vazhdojmë kështu, përgjigja është JO. Kur flitet për një vizion, ai duhet të jetë për një periudhë 20 apo 40 vjeçare. Kjo nënkupton se ky vizion duhet të jetë i njëjtë për të gjitha forcat kryesore politike të cilat me rrotacion do ta drejtonin shtetin gjatë kësaj periudhe. Pra, vizioni duhet të ketë, përkrahje të gjerë. Ai duhet të zhvillohet me kontributin dhe mbështetjen edhe të shoqërisë civile. Kur do arrijmë ne ta kemi këtë vizion? Çfarë duhet të bëjmë që ta arrijmë këtë? Përgjigja është e thjeshtë: duhet të ulen e diskutojnë, analizojnë dhe vendosin (duke e lënë mënjanë politikën e ditës) së bashku të gjithë aktorët relevante duke filluar nga Kuvendi, Qeveria, sindikatat, shoqëria civile; dhe patjetër që zëri i ekspertëve tanë duhet të dëgjohet mirë gjatë këtij procesi.


Vizioni i Kosovës për energjetikën duhet të bazohet në *Acquis* të BE-së, pa asnjë mëdyshje. Por, ai duhet të vendoset në përputhje me kushtet konkrete që i kemi në Kosovë. Ky vizion duhet të mbajë parasysh koston e zbatimit të tij, dhe kjo do të thotë se duhet të zërthehet në politika e strategji që maksimizojnë përfitimet e Kosovës. Këtë na e kërkon Kushtetuta, për këtë e flasim të gjithë aktorët, por këtë duhet ta bëjmë realitet. Përndryshe, kot e themi se jemi të pasur me burime natyrore kur ato i keqpërdorim, i falim (rasti i ferronikelit) apo nuk i shfrytëzojmë hiq sa, si e kur duhet, rasti i Trepçës.

Nëse vërtet vizioni ynë do ta bazonte zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në shfrytëzimin kryesisht edhe të burimeve tona natyrore, atëherë qasja aktuale ndaj këtyre burimeve duhet të ndryshojë krejt. Sot i falim burimet për të krijuar disa vende pune, nesër do duhet t'i japim (me procedura vërtet kompetitive) burimet, ato energjetike kryesisht, atyre investitorëve që ofrojnë më shumë për koncesionet për shfrytëzimin e tyre. Kështu veprojnë të gjitha vendet që janë në rrugën e zhvillimit dhe kanë resurse natyrore të konsiderueshme.

Energjetika jonë duhet të vizionohet në kushtet e një tregu të hapur energjetik rajonal dhe me gjerë, pra në kushtet e konkurrencës. Nuk duhet të synojmë të zhvillojmë energjetikën dhe të mbajmë të ulta çmimet e energjisë, kjo do të ishte politike populiste dhe mjaft e gabuar. Duke shmangur çmimet e energjisë nga ato të tregut, ne do të nxisim zhvillimin e industrive të rënda që harxhojnë shumë energji dhe ndotim mjaft mjedisin. Tendenca sot në vendet e zhvilluara është që këto industri të rënda 'të eksportohen' në vendet në zhvillim. Nëse ne e bëjmë këtë gabim, shpejt do t'i biem pishman dhe fëmijët e nipat tonë nuk do të na e falin.

Dhe ne fund, vizioni ynë duhet të definohet pasi të kemi kryer edhe disa analiza e studime të domosdoshme që do të na tregojnë se cili do të ishte ndikimi në mjedis dhe në shëndetin tonë nga zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese. Ne duhet të studiojmë dhe vendosim një balancë për atë që do të dakordohemi për të mirat dhe dëmet mjedisore dhe shëndetësore që shkakto-

hen nga zhvillimi energjetik kryesisht prej linjitit, pra e thënë me thjeshtë, ta dimë si popull/shtet dhe të dakordohemi për balancin që dëshirojmë mes jetës më të shëndetshme dhe mirëqenies më të mirë ekonomike. Alternativat janë: shfrytëzimi afatshkurtër (40-50 vite) apo afatgjatë i linjitit që posedojmë. Alternativa e dytë duket më e mira!



Kalendari i gabimeve dhe konkluzione kryesore

Në kalendarin e gabimeve kryesore të konstatuara gjatë viteve që punohet për përgatitjen e kushteve për ndërtimin e termocentralit të ri dhe zhvillimit të sektorit energjetik në tërësi mund të përmenden:

1. Politikat energjetike të hartuara nga konsulent të huaj gjatë viteve 2006-2009, të miratuara prej Qeverisë dhe të përcjella në BB, kanë rezultuar jo-adekuate dhe inkoherente. Ofrimi në vitin 2006 i një pakete projekti mjaft të madh në kapacitet dhe me shumë komponente (termocentrali i ri 1,800-2100MW, mihja e re e Sibovcit me rreth 1 miliard ton rezerva të linjit, dhe rivitalizimi i TC Kosova A⁶⁴) ka qenë gabimi fillestar. Strategjia e Energjisë 2005-2015 parashihte që termocentrali i ri të kishte fillimisht vetëm deri në 1,000Më.
2. Përgatitësit e huaj të pakos tenderuese për termocentralin e ri, në vijimësi gjatë viteve 2006-2012, nuk arritën të ofrojnë draftin e përshtatshëm të një pakoje tenderuese që do të kënaqte si interesat e investitorëve të përzgjedhur për projektin e termocentralit të ri ashtu edhe interesat e popullit të Kosovës, edhe pse Kosova ka qenë e angazhuar t'i ofrojë investitorëve fa-

64 Në mesin e vitin 2009, Qeveria e Kosovës u deklarua se do ta dekomisionon TC Kosova A deri në vitin 2015. Strategjia e Energjisë 2009-2018 parashih dekomisionimin e këtij termocentrali deri në vitin 2017.

voret dhe lehtësitë maksimale të mundshme.

3. Përfshirja, me propozim të Këshilltarëve të Transaksionit, e rivitalizimit të TC Kosova B në pakon tenderuese të Projektit Kosova e Re⁶⁵ në fund të vitit 2009, ishte veprim që jo vetëm e komplikoi Projektin, por edhe krijoi mundësinë për kalimin nga monopoli shtetëror në atë privat në sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike.
4. Dizajni për Modelin e Tregut të energjisë elektrike, i ofruar nga Këshilltarët e Transaksionit⁶⁶, u kritikua nga Komisioni Evropian sidomos gjatë vitit 2010. Për pasojë u humb akoma kohë dhe asnjëherë nuk u qartësua se si do duhej të jetë ky model në mënyrë që të përputhet me *Acquis* të BE-së.
5. Siç është paraqitur publikisht nga KDP (Komiteti Drejtues i Projektit Kosova e Re) gjatë viteve 2011-2012, kriteri kryesor përzgjedhës i fituesit të projektit Kosova e Re do të jetë çmimi më i ulët i energjisë elektrike⁶⁷. Kjo mund të nënkupton indirekt devalvim

65 Në fund të vitit 2009, Qeveria vendosi përfshirjen e TC Kosova B në Projektin Kosova e Re. Më pas, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi këtë vendim si shtesë e Strategjisë së Energjisë 2009-2018 të përcjellë më herët nga Qeveria për shqyrtim nga Kuvendi.

66 Ky dizajn parashikonte edhe krijimin e një kompanie publike që do të blinte gjithë energjinë që do të prodhohej nga KEK-u dhe importimin sipas nevojave, duke e ekspozuar kështu Qeverinë ndaj përgjegjësisë dhe rreziqesh potenciale që ishin në kundërshtim me *Acquis*.

67 Electrowatt-Ekono-Oy në draft-raportin "Studimet e para-fizibiliteteve për termocentralin e ri me linjit dhe për masat për reduktimin e ndotjeve në Termocentralin Kosova B", financuar nga

të vlerës së linjitit dhe mbajtje të çmimeve të energjisë elektrike nën çmimet e tregut rajonal. Ndërkohë, nëse kontratat afatgjata do të jenë me çmime nën treg, atëherë Qeveria si garantuese e projektit mund të përballlet me kosto të larta, sepse sipas *acquis* duhet që pas vitit 2015 çmimet të jenë të liberalizuara dhe të vendosura në tregun rajonal të energjisë elektrike.

6. Kur është nisur Projekti në vitin 2006, baza ligjore ka qenë e mangët, prona publike administrohej nga AKM-ja, dhe Kosova nuk e kishte të qartë statusin juridik si shtet (deri në shkurt 2008 kur edhe u shpall pavarësia) dhe kjo përbënte rrezik të madh për investitorët⁶⁸. Kjo realisht pamundësonte tërheqjen e investime marramendëse. Prej vitit 2008 baza ligjore kryesore është miratuar, por akoma ka vend për plotësime dhe amendime⁶⁹.

7. Ndërprerja nga MZHE e procesit të tenderimit për HC

AER në 2005, për termocentralin e ri shkruan: “Ne sugjerojmë një proces tenderues ku premiumi (“licence fee”) për linjitin do të ishte parametri kryesor (oferta më e lartë fiton).... Premiumi për linjitin mund të paguhet kesh (çdo muaj) ...”


68 Raporti i konsorciumit IPA & Norton Rose në 25 mars 2005, financuar nga ESTAP II, shënon: “Statusi i paqartë i Kosovës krijon një rrezik të madh politik për një investitor”.

69 Konkretisht Ligji për Miniera parasheh që licenca për shfrytëzim të linjitit të jepet për 35 vite me mundësi shtesë për 15 vjet. Kjo kërkesë konsiderohet pengesë e pa-arsyeshme nga investitorët privat, sepse rrit pasigurinë për mundësinë e shtesës së lejes së shfrytëzimit të mihjes. Kujtojmë se jetëgjatësia teknike e termocentraleve është rreth 40 vite, dhe kohëzgjatja e lejes së shfrytëzimit të linjitit është e arsyeshme të përputhet me këtë jetëgjatësi.

Zhur gjatë periudhës 2011-2012 ka shkaktuar vonesa të panevojshme. Ndërtimi HC Zhur është miratuar nga Kuvendi si pjesë e Strategjisë së Energjisë 2009-2018. Ndërkohë, duhet të avancohet edhe procesi për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla.

8. Nënshkrimi i marrëveshjeve për privatizimin e shërbimeve të distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike në 17 tetor 2012 ishte finalizimi i një procesi jo transparent me rezultat ‘faljen strategjike’ të këtij aseti jetik për vendin. Çmimi i privatizimit është qesharak. Modeli i privatizimit është dëshmuar i dështuar ekonomikisht, krijon monopol privat në furnizimin me energji, do të shkaktojë rritje enorme të çmimeve të energjisë duke filluar prej viteve 2013-2014, dhe çka është me e rëndësishme, cilësia e furnizimit me rrymë do të përkeqësohet nëse Qeveria nuk do të subvencionojë mjaft më shumë se deri tash importin e energjisë elektrike.

9. Tentativat në disa raste nga KEK sha për të rivitalizuar blloqet A1 dhe A2 në TC Kosova A, ajo më e fundit gjatë vitit 2012 kur edhe KEK filloi procesin e tenderimit për këtë qëllim, tregojnë për amullinë dhe rrëmujën institucionale në sektorin energjetik. Kujtojmë se Kuvendi nëpërmjet miratimit të Strategjisë së Energjisë 2009-2018, apo edhe Qeveria nëpërmjet fjalës së Kryeministrit në korrikun e vitit 2009 angazhohen ta dekomisionojnë TC Kosova A. Ky veprim i KEK sha (që është pronë publike nën ‘komandën’ e Qeverisë) ka bërë që Komisioni Evropian të reagojë



në disa raste duke kujtuar angazhimet tona për ta mbyllur TC A deri në vitin 2017. Mund të thuhet se të tilla veprime u dëshmojnë investitorëve potencial se institucionet tona, në këtë rast KEK sha, nuk i respektojnë vendimet.

10. Mos-dëgjimi dhe mos-konsiderimi në vazhdimësi i mendimit të kualifikuar alternativ të shprehur nga mjaft aktorë vendor ka krijuar një mjedis mbytës dhe të pafavorshëm për projektin, dhe investitorët e faktORIZOJNË këtë në riskun e perceptuar për projektin duke rritur koston e tij. Varësia e plotë dhe në vijimësi e Qeverisë ndaj ndërkombëtarëve dhe diktati i Qeverisë në Kuvendin e Kosovës ka eliminuar mundësinë e krijimit të terrenit të përshtatshëm për përgatitjen e duhur të projekteve madhore në sektorin energjetik.

Rekomandime të përgjithshme

Rekomandimet kryesore që duhet të konsiderohen nga Qeveria dhe Kuvendi mund të përmbledhen si vijon:

1. Nëpërmjet një procesi të udhëhequr nga aktorët vendore⁷⁰, të rishikohet, adoptohet dhe zbatohet pa mëdyshje një politikë dhe strategji energjetike bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse, e udhëhequr nga parimet dhe qasja Evropiane për energjinë, mjedisin dhe konkurrencën. Kjo politikë dhe strategji duke konsideruar kushtet aktuale të vështirësuar të financave ndërkombëtare për investime private, duhet të synojë forma dhe mundësi të tjera kreative dhe relevante për financime të projekteve madhore për sektorin tonë energjetik. Zbatimi i politikës dhe strategjisë së re kërkon që secili institucion relevant të luaj me përpikëri rolin e paraparë (duke filluar nga Kuvendi) dhe të mbahet përgjegjësi kur të jetë rasti.
2. Të gjitha institucionet kërkojnë t'i valorizojmë burimet energjetike në kushtet e tregut të lirë, të hapur dhe transparent; dhe për më tepër, synohet t'i maksimizojmë përfitimet prej tyre për Kosovën⁷¹. Prandaj,

70 Ekspertiza e huaj duhet të luajë rolin e vet të pazëvendësueshëm në këtë proces, por ajo duhet të jetë në vendin e pasagjerit dhe jo të shoferit si deri më tani.

71 Në faqen 35 të Strategjisë Minerare të Kosovës 2012-2025 shkruhet: "Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar të sigurojë që resurset minerale të jepen në shfrytëzim duke maksimizuar përfitimet për Kosovën në kushtet e një tregu të lirë, të hapur dhe transparent. Për këtë qëllim, synohet të krijohet një ambient ligjor, rregullator dhe fiskal tërheqës për investitorët, që i siguron Kosovës të ardhura të

institucioneve u mbetet detyra që ta zbatojnë me përpikëri këtë politikë ekonomike. Linjiti ynë e ka një vlerë të tregut⁷². Prandaj, e para që duhet të bëjmë është që të kujdesemi që çdo kontratë afatgjate për shit-blerje të energjisë ta konsideron këtë vlerë. Futja nëpër projekte, si deri më tani, i elementeve që deformojnë zbatimin e parimeve të tregut të lirë⁷³ do të jetë recetë për dështim edhe në të ardhmen.


3. Baza ligjore dhe rregulatore duhet të rishikohet dhe plotësohet me synim eliminimin edhe të hapësirave për monopole në treg. Nuk duhet të jetë p.sh. Projekti Kosova e Re që dikton bazën ligjore (siç ka ndodhur rëndom deri tani), por e kundërta - baza ligjore duhet të jetë ajo që kushtëzon formën dhe dizajnin e projekteve. Kërkesa për miratim përfundimtar nga Kuvendi i Kosovës i pakove të marrëveshjeve të negociuara dhe nënshkruara nga Qeveria duhet të bëhet kërkesë e qartë ligjore. Ky parashikim ligjor jo vetëm do të rrit sigurinë për investitorët privat, por edhe do e angazhon Kuvendin ta luajë sa dhe si duhet rolin në emër të sovranit popull⁷⁴.

të njëjtit nivel proporcional me vendet me eksperiencën më pozitive në optimizimin e shfrytëzimit të resurseve minerare."

72 Edhe pse nuk tregtohet direkt në berzat e qymyreve, ai e ka vlerën e vet, dhe kjo vlerë është pjesë e çmimit të energjisë elektrike që tregtohet në tregun e lirë. Çmimet e burimeve energjetike luhaten në berzat e tyre, dhe sipas tyre luhatet edhe çmimi i energjisë.

73 Kontratat afatgjata të shit-blerjes me çmime të fiksuara, apo mundësimi i monopolit në tregun me shumicë dhe pakicë të energjisë, etj.

74 Kjo procedurë është praktikë e njohur dhe e përhapur ndërkombëtare. Ajo zbatohet në vendet e rajonit përreth nesh. Atë e kërkojnë investitorët privat serioz për të qenë më të sigurt, por edhe sepse miratimet nga Parlamentet i kërkojnë zakonisht edhe bankat që kreditojnë këta investitor privat.



4. Projekti Kosova e Re duhet të riformatohet, ridizajnohet/copëtohet dhe ritenderohet. Ndarja e elementeve të pakos aktuale të këtij projekti në dy ose tri tender-projekte më të vogla⁷⁵ do të rritë shanset për të arritur finalizimin e objektivave. Ndërsa, në kushtet aktuale të financave botërore, një opsion i mirë, i shpejtë, dhe i lirë financimi për këto projekte do të ishte edhe mbështetja me kredi dhe/ose pjesëmarrja me akcione nga një konsorcium i disa bankave zhvillimore ndërkombëtare (BB, BERZH, BEI, etj.), pa përjashtuar këtu edhe mundësinë e kredive nga bankat komerciale vendore. Qeveria duhet që me kurajë dhe ngulm t'i kërkojë Bankës Botërore ta mbështesë këtë qasje dhe të vendoset në krye të përpjekjeve për zbatimin e saj. BB⁷⁶, BEI, dhe BERZH⁷⁷ i kanë pjesë të aktivitetit të tyre këto lloj të financimeve/kreditimeve. Na këshilloi BB dhe USAID ta provonim ndryshe, e provuam ashtu për mbi 6 vjet dhe dështuam mbase jo për faj të tyre, por tani duhet të jetë radha jonë – e institucioneve vendore - të propozojmë zgjidhje alternative, dhe kjo e shprehur më sipër është njëra prej tyre, e cila zbatohet

75 Projektet më të vogla do të ishin: Termocentrali i Ri, Rehabilitimi i TC Kosova B, dhe Mihja e Re. Meqë, zhvillimi i Mihjes së Re është në fazë të avancuar (aktualisht po prodhohet linjit në Sibovcin Jug-perëndimor), ajo mund të shkëputet nga KEK sh.a. dhe të inkorporohet si kompani publike e veçantë. Kjo kompani (Kompania e Mihjes së Linjtit) fillimisht mund të zhvillohet më tej si kompani në pronësi publike, por me menaxhim privat nëpërmjet një koncesioni për menaxhimin e saj modern dhe me efikasitet të lartë. Kompani menaxhuese me repute botërore ndodhen kryesisht në ShBA. Njëra prej tyre ka qenë deri vonë (viti 2009) e interesuar të angazhohen në zhvillimin e Mihjes së Re të Linjtit në Sibovc.

76 Në vitin 2010, BB kreditoi shumën \$US 3.75 miliard për ndërtimin e një termocentrali me qymyr në Afrikën e Jugut.

77 Kosova pritet që së shpejti të anëtarësohet në BERZH. Kjo bankë ka bashkëfinancuar shumë projekte termocentralesh në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore.

het rëndom në vendet në zhvillim.

5. Potencialet e burimeve të përtëritshme duhet t'i shfrytëzojmë mjaft më shumë. Qeveria duhet të (1) vazhdojë pa vonesa procesin e ndërprerë, pa arsye të qenësishme, të tenderimit për HC Zhur; (2) avancojë procesin për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, (3) nxisë shfrytëzimin e energjisë së erës dhe biogazit për energji elektrike, si dhe (4) miratojë masa të nevojshme ashtu që brenda një periudhe ekonomikisht të arsyeshme të instalohen panele të ngrohjes diellore të ujit për nevoja sanitare në objektet kryesore publike në të gjitha komunat e Kosovës, atje ku ka kërkesë dhe është e përshtatshme.
6. Në fund, por shumë e rëndësishme, është edhe eficientia e energjisë. Planet dhe planifikimi për këtë fushë janë përgatitur tashmë, dhe objektivat e caqet e vendosura janë shumë ambicioze. Ato janë në përputhje me Acquis për energji të BE-së. Veprimet më kryesore që kërkohet të ndërmerren nga institucionet janë: (1) zbatimi i një kornize rregullatore nxitëse për eficientë, (2) aplikimi i një pakete masash nxitëse fiskale për teknologjitë eficientë, (3) zhvillimi institucioneve mbështetëse⁷⁸, dhe (4) avancim i skemave mbështetëse financiare për rritjen e eficientës në kushtet e tregut për periudhën afatgjatë⁷⁹.

78 Ligji për Eficientë e Energjisë, i dekretuar në 8.7.2011, parashikon krijimin e Agjencisë së Eficientës. Kjo agjenci nuk është funksionalizuar akoma.

79 Në një fazën të parë, masat për rritje të eficientës mund të mbështeten edhe me subvencione të pjesshme në disa forma, por këto subvencione duhet të reduktohen deri në eliminim kur kushtet e tregut ta mundësojnë këtë.

